



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 29/47 Prot.

Tiranë më 24.04.2024

V E N D I M
Nr. 27 datë 24.04.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

| | |
|------------------------|-----------------|
| Henri Naqellari | Kryesues |
| Loreta Hanxhari | Relatore |
| Bora Vrenjo | Anëtare |

asistuar nga sekretarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Ersila Kalaja në datën 11.04.2024, ora 10:30, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Znj. Shpresa Ibrahim Latifi, me funksion aktual Drejtore e Drejtorisë së Financës në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Loreta Hanxhari, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar (në vijim Ligji 12/2018, i ndryshuar).
2. Bazuar në Nenin 6 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, shtetasja *Shpresa Latifi* është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mban.
3. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, më datë 05/04/2022 ka shortuar Trupën Vlerësuese dhe relatorin e çështjes për subjektin e vlerësimit Znj. *Shpresa Latifi* për tju nënshtuar procesit të vlerësimit kalimtar, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar”, të përbërë nga Relatore Znj. Loreta Hanxhari, Kryesues Z. Henri Naqellari dhe Anëtare Znj. Bora Vrenjo.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, më datën 18/04/2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 dt.28.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”, me Vendimin nr.1 datë 18.04.2023 vendosi:
 - Të fillojë hetimi kryesisht për subjektin e vlerësimit Znj. *Shpresa Latifi* me funksion Drejtore e Drejtorisë së Financës në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Të njoftojë me shkrim subjektin e vlerësimit për fillimin e hetimit.
 - Të bëhet njohja e subjektit të vlerësimit me përbërjen e trupës së vlerësimit për të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit të subjektit me trupën.

6. Bazuar në nenin 49 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Znj. *Shpresa Latifi* në datën 18/04/2023 është njoftuar në adresën elektronike zyrtare të saj, për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, është njohur me përbërjen e Trupës së Vlerësimit, dhe i është kërkuar të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit sa më sipër.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. ** prot. datë 19.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.** prot., datë 19.04.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 19.04.2023, pranë DPPSH-së, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 19.04.2023, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
9. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
10. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të Nenit 25, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në Nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (*i ndryshuar*) ka për objekt:
- a) *vlerësimin e pasurisë;*
 - b) *kontrollin e figurës;*
 - c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*
13. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
- a) Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b) Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c) Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d) Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - e) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
 - f) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar
 - g) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*

- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*
- *ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3 pika 12 dhe 14 të ligjit 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

15. Trupa e vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Shpresa Latifi, me Vendimin nr. 3, datë 08.03.2024, vendosi:

- a) Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Shpresa Latifi;
- b) Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*

- *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c) Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

16. Subjekti i vlerësimit, pas dërgimit të relacionit paraprak dhe njoftimit me e-mail datë 11.03.2024, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, e ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve duke dhënë sqarime mbi disa gjetje të pasqyruara në relacion. Sqarimet e paraqitura së bashku me dokumentacionin shoqërues, pasi u administruan, u analizuan dhe në përfundim u konkludua se nuk përbëjnë fakte të reja, por mbeten në kuadrin e sqarimeve të dhëna paraprakisht edhe gjatë fazës së hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i vlerësimit Shpresa Latifi u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 09.04.2024, ku dhe u njoftua se seanca publike dëgjimore është përcaktuar për t'u mbajtur në datën 11.04.2024, ora 10:30, në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.
18. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.
19. Subjekti i vlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Shpresa Latifi kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

20. Znj. Shpresa Latifi ka qenë bashkëpunuese në procesin e vlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Në bazë të nenit 32, pika 1, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaroi çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
22. Trupa e vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

23. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të Ligjit 12/2018 të ndryshuar.
24. Sipas kreut III, neni 33/1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
25. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:
- *verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;*
 - *në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;*
 - *në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;*
 - *në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.*
26. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:
- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
 - b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
 - c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
 - ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.
27. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklaratime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.
28. Subjekti i vlerësimit Znj. Shpresa Latifi ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklaratimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
29. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në përfundim të raportit të saj, ka konstatuar se:
- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;

- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të remë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

- 1. Apartament banimi me sip. 71,5m2, në adresën Rr. "I. T.", pallati 6-katësh, "Pallati i Ri", i blerë në datën 23.12.2000, me kontratën nr. ** rep., nr. ** kol. Vlera 1.700.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e krijuara nga kontrata e shitjes nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 03.01.2001, për apartamentin në Rr. "H. H.", pallati i policisë (ndarja e pasurisë me ish-b/shortin) në shumën 1.800.000 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 23.12.2000, për apartament me sip. 71,5m2, në Rr. "I. T.", Tiranë. Blerës: Shpresa Gashi. Shitës: Shoqëria "Myzeqeja" sh.p.k. Çmimi: 1.700.000 lekë i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. 736, dt. 28.12.2000, për pasurinë e llojit apartament me sip. 71,5m2, Rr. "I. T.", Tiranë, regjistruar në pronësi të Shpresa Gashi.
- Planimetri e apartamentit datë 17.07.1995, për apartamentin në Rr. "H. H.", Tiranë, me blerës Azem Duraku dhe shitës EKB Tiranë, me vlerën 1.180.375 lekë.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. 7208, dt. 14.09.1995, për pasurinë e llojit apartament me nr. pasurie **, me sip. 67,5m2, Rr. "H. H.", "Pallati i Policisë", Tiranë, regjistruar në pronësi të Azem dhe Shpresa Duraku.
- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 03.01.2001, për apartament në Rr. "H. H.", "Pallati i Policisë", Tiranë. Shitës: Shpresa Duraku. Blerës: Azem Duraku. Shitësi shet ½ e pasurisë (pjesën e vet takuese), blerësit Azem Duraku. Çmimi: 1.800.000 lekë, shumë e likuiduar).
- Kontratë shitje nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 07.03.2005, për apartament me sip. 71,5 m2, me nr. pasurie **, në Rr. "I. T.", Tiranë. Shitës: Shpresa Gashi. Blerës: B. T. Çmimi: 1.900.000 lekë, i lëvruar jashtë zyrës noteriale.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 1.1 ASHK Tiranë - DV Zonat e Stimuluara, DV Tirana Jug, DV Tirana Veri, DV Tirana Rurale 1, DV Tirane Rurale 2, DV Kamëz Vorë, me shkresat nr. ** prot, dt. 16.06.2023, 26.06.2023,

03.07.2023, 21.06.2023, 07.07.2023, 29.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Shpresa Latifi.

- 1.2 Subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim ku deklaron se apartamenti në rrugën "H. H.", është marrë pa pagesë nga Ministria e Rendit Publik në atë kohë, sot Ministria e Brendshme, si oficer policie. Apartamenti ka qenë pronë shtetërore dhe më pas është blerë tek Enti Kombëtar i Banesave në vlerën 1.180.375 lekë. Në fillim është paguar 10% e vlerës dhe pjesa tjetër ka qenë tarifë për t'u paguar cdo muaj. Për pagesën e tarifave subjekti shpjegon se kjo mënyre pagese ka vazhduar deri në vitin 1998 kur ajo është ndarë me b/shortin, pavarësisht se ata kanë vijuar të jetojnë në të njëjtin apartament deri në vitin 2000, kur u mbyll procesi i divorcit. (bashkëngjitur Vendim nr. **, dt. 06.12.2000, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, i cili ka vendosur zgjidhjen e martesës midis Shpresa Gashi dhe Azem Duraku.) Pas vitit 1998, subjekti nuk ka informacion se si është kryer likuidimi i apartamentit (nga ish-b/shorti). Shuma që është paguar tek Enti i Banesave ka pasur si burim financiar kursimet në vite nga të ardhurat. Lidhur me shitjen apartamentit në rrugën "H. H.", sqaroi se pagesa prej 1.800.000 lekë i është bërë gjatë muajit dhjetor, (pavarësisht se kontrata e shitjes është lidhur në datën 03.01.2001) shumë e përdorur për të blerë, në datën 23.12.2000, apartamentin me sip. 71.5m², në rrugën "I. T."
- 1.3 Nga Enti Kombëtar i Banesave me shkresën nr. ** prot., datë 13.02.2024 të ardhur kthim përgjigje tonës, na është vënë në dispozicion dokumentacioni në lidhje me pasurinë nr. **, zk.8380, me adresë Rruga "H. H.". Sipas kontratës së shitjes midis EKB dhe Z. Azem Duraku, ajo cilësohet me pagesë të menjëhershme dhe vlera e apartamentit është përlogaritur 265.516 lekë meqenëse blerësi ka dorëzuar një apartament 55.1 m² të ndodhur në rrugën "I. D.", Tiranë, i cili është vlerësuar në shumën 801.066 lekë. Shuma është likuiduar menjëherë sipas mandat arkëtimit nr.416, datë 17.07.1995.
- 1.4 Në lidhje me mobilimin e apartamentit në rrugën "H. H.", subjekti ka sqaruar se për mobilimin disa pajisje janë blerë të reja, ndërsa disa të tjera janë blerë të përdorua. Blerjet e tyre nuk janë kryer në të njëjtën kohë, por në vijimësi dhe cmimet nuk i kujtohen, pasi kanë kaluar shumë vite. Ndërsa për apartamentin në rrugën "I. T.", subjekti sqaroi se për mobilimin e tij ka paguar 120.000 lekë për disa pajisje dhe mobilje, pasi disa mobilje i ka blerë të përdorura dhe disa të tjera i ka marrë nga apartamenti i mëparshëm (në rrugën "H. H.").
- 1.5 Në datën 23.12.2000, subjekti ka blerë një apartament në rrugën "I. T.", Tiranë, për shumën 1.700.000 lekë. Si burim financiar të shumës 1.700.000 lekë të përdorur për blerjen e këtij apartamenti, subjekti deklaron se ka përdorur të ardhurat në shumën 1.800.000 lekë, të përfituara nga shitja e pjesës takuese që kishte me ish-b/shortin e saj, shetasin Azem Duraku, të apartamentit në rrugën "H. H.". Lidhur me faktin se kontrata e shitjes së apartamentit në rrugën "H. H." është lidhur me datë 03.01.2001 (pra pasi është lidhur kontrata e blerjes për

apartamentin në rrugën "I. T.", datë 23.12.2000), subjekti shpjegon se pavarësisht se kontrata është lidhur më pas, për shkak të festave të fundvitit, shuma e parave prej 1.800.000 lekë është paguar gjatë muajit dhjetor (2000) dhe është përdorur si burim financiar për blerjen e apartamentit në rrugën "I. T.". Apartamentin në rrugën "I. T.", subjekti e ka shitur në vitin 2005 për shumën 1.900.000 lekë.

1.6 Nga dokumentacioni i administruar duket qartë se veprimet e shlyerjes së detyrimit, si në blerje dhe në shitje janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe tërësisht likujduar në cash. Fakti që të dyja shumat si e përfituara dhe e paguara nga ana e subjektit kanë ndodhur jashtë zyrave noteriale dhe palët nuk kanë asnjë pretendim, mund të na cojnë në pranimin e argumentit që subjekti i ka marrë 1.800.000 lekë para datës së shlyerjes së detyrimit të blerjes së apartamentit në Rrugën "I. T." dhe veprimet të jenë kryer më pas për shkak të festave të fundvitit.

1.7 ASHK nuk i konfirmon në pronësi të subjektit apartamentet në Rr."H. H." dhe Rr. "I. T.".

1.8 Nga shitja e pjesës takuese të apartamentit në rrugën "H. H.", subjekti deklaron se ka përfituar 1.800.000 lekë, por sipas kontratës noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.01.2001, shitësi likujdon tatimin mbi shitjen në masën 0.5%. Në analizën financiare trupa vlerësuese ka marrë parasysh përfitimin pas pagimit të tatimit, i cili është rreth 1.661.193 lekë.

✓ **Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës takuese të tij janë marrë përpara lidhjes së kontratës së shitjes dhe janë përdorur më pas për blerjen e apartamentit tjetër në rrugën "I. T.", por rezulton se të dy apartamentet janë blerë përpara vitit 2008 dhe për to është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, i ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

2. Autoveturë Seat Ibiza, nuk kam dokumentacion e blerjes, e kam blerë 450.000 lekë në vitin 2001. Vlera 450.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e kursyera në vitin 2001.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2.1 DPSHTRR, me shkresën nr. ** prot, datë 09.05.2023, nuk konfirmon mjet të regjistruar në emër të Shpresa Latifit.

2.2 Në datë 12.07.2023, subjekti ka sqaruar me shkrim, ku deklaron se nuk ka dokumentacion për blerjen e autoveturës, por sqaroi se e ka blerë 450.000 lekë në vitin 2001, me kursimet e

krijuara deri në atë periudhë. Në fund të vitit 2005 ose fillim të vitit 2006 e ka shitur automjetin në shumën 480.000 lekë, por nuk ka dokumentacionin e shitjes (para blerjes i ka bërë riparime, ndaj është shitur më shumë se cmimi i blerjes). Subjekti deklaron se ka kërkuar dokumentacionin edhe tek Drejtoria e Transportit, por nuk dilnin në sistem të dhënat për vitet 2005 - 2006.

2.3 Subjekti ka dorëzuar kërkesë me postë elektronike, datë 03.07.2023 nga Shpresa Latifi (Gashi), drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ku kërkon informacion për mjetet që ka pasur në pronësi duke cituar dhe faktin se nuk e mban mend targën e mjetit në fjalë, si dhe përgjigje me postë elektronike nga DPSHTRR, datë 03.07.2023, ku e informon Shpresa Gashin, se në emrin e saj nuk ka dhe nuk ka pasur mjete të regjistruara.

✓ **DPSHTRR nuk konfirmon automjet në emër të subjektit. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me blerjen dhe shitjen e këtij automjeti por për sa deklaruar, ky automjet është blerë dhe shitur përpara vitit 2008 dhe për të është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, i ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

3. **Apartament në Rr. "R. P.", kompleksi "Usluga", seksioni x, apartamenti nr. x, Tiranë, me kontratë nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 15.04.2008. Vlera 32.175 euro, ose 3.938.542 lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë së datës 15.04.2008, ku 1 euro = 122,41 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Nga shitja e apartamentit, sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 07.03.2005, në Rr. "I. T.", në shumën 1.900.000 lekë, Nga shitja e autoveturës Seat Ibiza, nuk kam dokumentacionin e shitjes, në shumën 480.000 lekë, shitja është bërë në fund-vitin 2005, ose fillim 2006. Marrë hua vëllait në Athinë, Greqi 500.000 lekë në muajin dhjetor të vitit 2007, 1.058.542 lekë nga kursimet në vite.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 15.04.2008, për pasurinë e llojit apartment, me nr. pasurie **, me sip. totale 102,06 m² (93,26 + 9,36m² shkallë), Rr. "R. P.", Tiranë. Blerës: Shpresa Gashi. Shitës: Shoqëria "Usluga" sh.p.k. Çmimi: 32.175 euro, shumë e likuiduar.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasuri e llojit apartment me nr. pasurie **, me sip. 93,26m², Rr. "R. P.", Tiranë, regjistruar në emër të Shpresa Latifit, regjistruar me datë 12.06.2008.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. 849739, dt. 26.12.2013, për pasuri e llojit apartment, me nr. pasurie **, me sip. 93,26m², Rr. "R. P.", Tiranë, regjistruar në emër të Shpresa Latifit.
- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme me rezervë me kalim pronësie nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 17.06.2022, për apartment me sip. 93,26m², me nr. pasurie **, në Rr. "R. P.", Tiranë,

i rivlerësuar në vlerën 15.000.000 lekë. Shitës: Shpresa Latifi. Blerës: B. K. cmimi: 125.000 euro, do të paguhet në llogarinë e noteres E. S. në BKT, brenda 3 muajve nga lidhja e kësaj kontrate, pas miratimit të kredisë që ka aplikuar pala blerëse. Palët bihen dakord që për qëllimin e kredisë, pasuria të bllokohet në favor të BKT, si barrë hipotekore e radhës së dytë. Palët bihen dakord që noteria të bëjë transferimin e cmimit të blerjes në Tirana Bank.

- Kontratë shitje nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 07.03.2005, për apartment me sip. (71,5m2), me nr. pasurie **, në Rr. "I. T.", Tiranë. Shitës: Shpresa Gashi. Blerës: B. T. Çmimi: 1.900.000 lekë, i lëvruar jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim page nr. ** prot, dt. 28.02.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, për të ardhurat e Shpresa Latifit, për periudhën tetor 1991 - prill 2005 nga pagat dhe shpërblimet në shumën 4.020.775 lekë (mungojnë listë-pagesat e plota për periudhën 2001 - 2002).

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.1 ASHK Tiranë - DV Zonat e Stimuluara, DV Tirana Jug, DV Tirana Veri, DV Tirana Rurale I, DV Tiranë Rurale 2, DV Kamëz Vorë, me shkresat nr. ** prot, datë 16.06.2023, 26.06.2023, 03.07.2023, 21.06.2023, 07.07.2023, 29.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Shpresa Latifi.

3.2 Subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku deklaron se për apartamentin e blerë në kompleksin "Usluga" Rr. "R. P.", Tiranë, disponon vetëm kontratën nr. ** rep., nr. ** kol, datë 15.04.2008 (dhe nuk disponon kontratën e porosisë/sipërmarrjes). Subjekti deklaron se në këtë apartament ka nisur të banojë në janar të vitit 2006 dhe kjo vërtetohet me pagesën e parë të faturës së energjisë elektrike, sipas kontratës nr. D/xxxxx (me emrin Shpresa Ibrahim Gashi). Cmimin e blerjes e ka paguar në dy këste, kësti i parë në dhjetor 2005 ose janar 2006 në shumën 27.000 euro, ndërsa diferenca është paguar në periudhën mars-prill 2008. Për një periudhë 1-vjeçare ka jetuar tek banesa e motrës N. Xh., në rrugën "H. L.", banesë private, në Tiranë.

3.3 Për burimin financiar të blerjes së këtij apartamenti, subjekti sqaron se i ka marrë hua, në muajin dhjetor të vitit 2007, 500.000 lekë vëllait të saj, A. Gashi emigrant në Athinë Greqi, i cili ka qenë ushtarak bashkë me bashkëshorten në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes. Këtë detyrim e ka shlyer nga kursimet nga të ardhurat e saj familjare. Vëllai A. Gashi ka ndërruar jetë në Greqi në datën 09.04.2021.

3.4 Në datë 11.07.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Kërkesë me shkrim, datë 26.06.2023, nga Shpresa Latifi, drejtuar FSHU-së, ku i kërkon informacion për kontratat e energjisë në emër të saj.

- Kthim përgjigje nr. ** prot, dt. 05.07.2023, nga FSHU, drejtuar Shpresa Latifit, e cila sipas dokumentacionit bashkëlidhur konfirmon se kontrata e energjisë nr. TR2Dxxxxxxxxx, për apartamentin me nr. pasurie **, në kabinën "USULGA" në emër të Shpresa Latifi (Gashi), është hapur në datën 24.12.2005 dhe ka kaluar në emrin e B. K., në datën 15.09.2022.

3.5 Subjekti ka dhënë sqarime me shkrim ku deklaroi se për mobilimin e apartamentit në rrugën "I. T.", fillimisht ka blerë dhomën e gjumit e cila ka kushtuar 80.000 lekë, si dhe elektroshtëpiake të reja, por edhe të përdorura, për një shumë prej 95.000 lekë. Në vitin 2018 ka blerë përsëri disa elektroshtëpiake, për një shumë prej 161.390 lekë. Bashkëlidhur paraqiti:

- Faturë tatimore shitje datë 06.01.2018, lëshuar nga Globe sh.p.k., në emër të Astrit Latifit, për blerje elektroshtëpiake, në shumën 75.200 lekë.
- Faturë tatimore shitje datë 19.02.2018, lëshuar nga Globe sh.p.k., në emër të Astrit Latifit, për blerje elektroshtëpiake në shumën 86.190 lekë.

3.6 Për mobilimin e apartamentit në rrugën "R. P." të blerë në vitin 2005-2006, subjekti deklaroi se ka shpenzuar ndër vite rreth 336.000 lekë. Do të konsiderohen shpenzime mobilimi vetëm 175.000 lekë, të cilat janë kryer në vitin e blerjes së apartamentit. Blerjet elektroshtëpiake në vitet e mëvonshme janë përfshirë në zërat e shpenzimeve jetike të INSTAT.

3.7 I është kërkuar subjektit që meqenëse vëllai i saj i ndjerë nuk jeton më, dhe meqenëse shuma e marrë hua ishte nga pagat që merrte vëllai në Shqipëri nga pensioni i parakohshëm për vete dhe gruan, të na vinte në dispozicion një deklaratë të nënshkruar nga bashkëshortja e vëllait (kunata) mbi shumën e dhënë hua dhe periudhën që është shlyer huaja. Në përgjigjet e datës 16.01.2024 subjekti ka bashkëlidhur e-mailin dërguar nga H. Gashi(nipi) dhe N. Gashi (kunata) ku deklarohet se: "Unë, N. Gashi, banore Athinë, Greqi nga viti 1997 konfirmoj se në muajin dhjetor 2007, bashkëshorti im, Z. A. Gashi i ka dhënë hua motrës së tij, Shpresa Gashi shumën 500 mijë lekë për pagesën e shtëpisë së blerë, këtë shumë me sa mbaj mend na i ka kthyer pas 3 vjetësh. Lekët janë siguruar nga pensionet e parakohshme që marrim."

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me shpjegimet e dhëna dhe me dokumentacionin e paraqitur. ASHK nuk e konfirmon në pronësi të subjektit apartamentin në Rrugën "R. P."**
- ✓ **Të ardhurat e përfituara nga shitja e autoveturës Seat Ibiza, të deklaruar si një pjesë burimi për blerjen e pasurisë, Trupa Vlerësuese nuk i ka marrë në konsideratë në analizën financiare për arsyen e trajtuar më lart.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

4. Pasuri e paluajtshme, arë, me sip. 1.595m², me nr. pasurie **, zk. 2850, ZVRPP Përmet. Bashkëpronare. Pjesa takuese 16,667%, 265,83m². Data e regjistrimit 30.04.2022. Vlera 0 lekë. Përfituar me Vendim për Lëshimin e Trashëgimisë Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 09.03.2022.
5. Pasuri e paluajtshme, vresht, me sip. 881m², me nr. pasurie **, zk. 2850, ZVRPP Përmet. Bashkëpronare. Pjesa takuese 16,667%, 146,83m². Data e regjistrimit 30.04.2022. Vlera 0 lekë. Përfituar me Vendim për Lëshimin e Trashëgimise Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 09.03.2022.
6. Pasuri e paluajtshme, arë, me sip. 2.648m², me nr. pasurie **, zk. 2850, ZVRPP Përmet. Bashkëpronare. Pjesa takuese 16,667%, 441,33m². Data e regjistrimit 30.04.2022. Vlera 0 lekë. Përfituar me Vendim për Lëshimin e Trashëgimisë Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 09.03.2022.
7. Pasuri e paluajtshme, arë + truall, me sip. 5.500m², nga të cilat ndërtesë 40m², me nr. pasurie **, zk. 2850, ZVRPP Përmet. Bashkëpronare. Pjesa takuese 16,667%, 916,66m². Data e regjistrimit 30.04.2022. Vlera 0 lekë. Përfituar me Vendim për Lëshimin e Trashëgimisë Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 09.03.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ** rep., ** kol, datë 09.03.2022, ku është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Astrit Latifi, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, bashkëshorten Shpresa Latifi (dhe fëmijët nga martesë e parë), vajzën M. Latifi dhe djalin E. Latifi.
- Certifikatë martesë datë 14.01.2022, për b/shortët Astrit Latifi dhe L. M., lidhur më datë 09.12.1993.
- Vendim nr. **, datë 05.10.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjygjësor, Elbasan, ku është vendosur zgjidhja e martesës mes shtetasve L. Latifi (b/shortja e parë) dhe Astrit Latifi.
- Certifikatë martesë datë 14.01.2022, për b/shortet Astrit Latift dhe Shpresa Gashi, martesë e lidhur me datë 29.07.2011.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 30.04.2022, për pasuri e llojit arë me nr. pasurie **, me sip. 1.595m², Përmet, regjistruar në emër të Shpresa Latifi për 1/6 pjesë.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 30.04.2022, për pasuri e llojit vresht me nr. pasurie **, me sip. 881m², Përmet, regjistruar në emër të Shpresa Latifi për 1/6 pjesë.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 30.04.2022, për pasuri e llojit arë me nr. pasurie **, me sip. 2.648m², Përmet, regjistruar në emër të Shpresa Latift për 1/6 pjesë.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 30.04.2022, për pasuri e llojit arë + truall me nr. pasurie **, me sip. 5.500m², truall me sip. 40m² dhe ndërtesë me sip. 40m², Përmet, regjistruar në emër të Shpresa Latifi për 1/6 pjesë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

4.1-7.1 ASHK Përmet me shkresën nr. ** prot, datë 06.07.2023, nuk i konfirmon këto pasuri në emër të subjektit.

4.2-7.2 Në datë 12.07.2023, subjekti ka sqaruar me shkrim ku deklaroi se pasuritë në Përmet, bashkëshorti i saj i ka përfutur sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol, datë 03.09.2003, duke i blerë nga babai, nëna, vëllai dhe kunata e tij, në shumën 200.000 lekë. Subjekti sqaroi se aktualisht nuk shfrytëzon asnjë nga këto pasuri. Gjithashtu shpjegoi se në pjesën takuese të pasurive të paluajtshme të përfutura me trashëgimi nga b/shorti i ndjerë, është përfshirë dhe ish-bashkëshortja e b/shortit.

4.3-7.3 Subjekti bashkëlidhur ka dorëzuar:

- Kontratë shitje nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 03.09.2003, për pasurinë e llojit arë: parcela me nr. ** me sip. 1.595m²; parcela me nr. ** me sip. 881m²; parcela me nr. ** me sip. 2.648m² dhe parcela me nr. ** me sip. 5.500m², në fshatin e Pacomit, Përmet. Blerës: Astrit Latifi. Shitës: V., F., B. dhe L. Latifi. cmimi: 200.000 lekë i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 03.07.2003, për pasurinë e llojit arë me sip. 1.595m², me nr. pasurie **, Përmet, regjistruar në emër të V. Latifi.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 03.07.2003, për pasurinë e llojit vresht me sip. 881m², me nr. pasurie **, Përmet, regjistruar në emër të V. Latifi.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 03.07.2003, për pasurinë e llojit arë me sip. 2.648m², me nr. pasurie **, Përmet, regjistruar në emër të V. Latifi.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 03.07.2003, për pasurinë e llojit arë me sip. 5.500m², me nr. pasurie **, Përmet, regjistruar në emër të V. Latifi.

4.4-7.4 Në sqarimet me shkrim të datës 15.08.2023, subjekti ka deklaruar se lidhur me ndryshimin e pasurisë nr. **, nga lloji "Arë" me sip. 5.500m² në "Arë + truall", në vitin 2014, në këtë pasuri, në një sipërfaqe prej 40m² është bërë ndërtimi informal i një magazine me blloqe betoni dhe mbulesë llamarine, vetëdeklaruar për legalizim në datën 19.08.2014. Ndërtimi i magazinës në vitin 2013, është bërë nga familja dhe janë blerë vetëm materialet të cilat kanë kushtuar 100.000 lekë. Bashkëlidhur paraqiti:

- Deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit, nr. ** prot, dt. 19.08.2014, nga Astrit Latifi, për ndërtim pa leje të ngritur në vitin 2013.
- Leje legalizimi nr. **, dt. 26.09.2015, për pasurinë e llojit godinë shërbimi I-kat, me nr. **, me sip. 40m², në fshatin e Poçamit, Bashkia Përmet, regjistruar në emër të Astrit Latift.

- Regjistri i parcelës ndërtimore për pasurinë e llojit truall me nr. **, me sip. 40m2, në fshatin e Poçamit, Bashkia Përmet, regjistruar në emër të Astrit Latift.
- Fotografi me ngjyra të objektit të legalizuar (ku pamjet përputhen me përshkrimin e bërë nga subjekti).
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti. ASHK Përmet nuk i konfirmon këto pasuri të regjistruara në emër të subjektit, por subjekti ka paraqitur certifikatat e regjistrimit të pasurive, të cilat e konfirmojnë deklarimin.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së krijuar pas vitit 2011, moment në të cilin Z. Astrit Latifi është personi i lidhur i subjektit të vlerësimit.**

8. Pasuri e paluajtshme, truall + ndërtesë, me sip. 83 m2 truall, 83 m2 ndërtesë, me nr. pasurie **, zk. 8523, ZVRPP Elbasan. Bashkëpronare. Pjesa takuese 16,667%, 13,83m2. Data e regjistrimit 15.04.2022. Vlera 0 lekë. Përfituar me Vendim për Lëshimin e Trashëgimisë Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 09.03.2022.

9. Pasuri e paluajtshme, truall, me sip. 73,70 m2, me nr. pasurie **, zk. 8523, ZVRPP Elbasan. Bashkëpronare. Pjesa takuese 66,667%, 49,13m2. Data e regjistrimit 15.04.2022. Vlera 0 lekë. Përfituar me Vendim për Lëshimin e Trashëgimisë Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, dt. 09.03.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë regjistrimi pronësie datë 15.04.2022, për pasuri e llojit truall me nr. pasurie **, me sip. 83m2, Elbasan, regjistruar në emër të Shpresa Latift për 1/6 pjesë.
- Certifikatë regjistrimi pronësie datë 15.04.2022, për pasurinë e llojit truall me nr. pasurie **, me sip. 73,7m2, Elbasan, regjistruar në emër të Shpresa Latifi për 4/6 pjesë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

8.1-9.1 ASHK Elbasan, me shkresën nr. ** prot, datë 30.06.2023, konfirmon të regjistruar në b/pronësi të Shpresa Latifi, pasuritë me nr. ** dhe nr. **. Bashkëlidhur: Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ** rep., nr. ** kol, datë 09.03.2022, ku është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Astrit Latifi.

8.2-9.2 ISSH, me shkresën nr. ** prot, dt. 10.05.2023, për periudhën nga viti 2012 e në vazhdim që disponon të dhëna, konfirmon se Astrit Latifi, për periudhën janar 2012 -shkurt 2021, ka përfituar të ardhura pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në shumën 8.446.822 lekë.

8.3-9.3 Në datë 12.07.2023, subjekti ka sqaruar me shkrim se b/shorti i saj, me kontratën nr. ** rep., nr. ** kol., datë 17.03.2000, ka blerë nga një shtetas një dyqan me sip. 20.2 m2, në shumën 600.000 lekë, më pas, sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.03.2000, ka blerë nga babai i tij edhe një dyqan tjetër me sip. 62.8m2, në shumën 100.000 lekë (duke krijuar pasurinë ndërtesë me sip. 83m2 me nr. pasurie **). Pasuria tjetër me nr. ** është blerë nga b/shorti sipas kontratës me nr. ** rep., nr. ** kol., të datës 18.11.2015, në shumën 552.898 lekë. Për burimin financiar të përdorur për blerjen e këtyre pasurive, subjekti ka deklaruar se janë përdorur të ardhurat nga pagat e kursyera ndër vite.

8.4-9.4 Bashkëlidhur, subjekti ka dorëzuar:

- Kontratë shitje nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.03.2000, për pasurinë e llojit dyqan me truall me sip. 20,2m2, me nr. pasurie **, në Elbasan. Blerës: Astrit Latifi. Shitës: M. D. Cmimi: 600.000 lekë i likuiduar.
- Vërtetim hipotekor dt. 06.03.2000, për pasurinë në emër të M. D. dhe harta treguese.
- Kontratë shitblerje nr. ** rep., nr., ** kol., dt. 28.03.2000, për pasurinë e llojit shtëpi me sip. 62,8 m2, me nr. pasurie **, në Elbasan. Blerës: Astrit Latifi. Shitës: V. Latifi. Çmimi: 100.000 lekë i likuiduar.
- Vërtetim hipotekor datë 28.03.2000, për pasurinë në emër të Astrit Latifit dhe harta treguese.
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 24.09.2013, për pasurinë e llojit truall, nr. pasurie **, me sip. 83 m2, nga të cilat 83 m2 ndërtesë, Elbasan, regjistruar në emër të Astrit Latifit.
- Kontratë shitje nr. ** rep, nr. ** kol, datë 18.11.2015, për pasurinë truall shtesë funksional i objekteve "riparime të ndryshme, Zyra", si dhe "Reparti i Pllakave Elbasan, me sip. 73,7m2 me nr. pasurie **. Blerës: Astrit Latifi. Shitës: Ministria e Financave. Çmimi: 552.898 lekë i likuiduar.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.12.2015, për pasurinë e llojit truall me nr. pasurie **, me sip. 73, 7 m2, Elbasan, regjistruar në emër të Astrit Latifit.

8.5-9.5 Në datë 15.08.2023, subjekti pranë ILDKPKI-së ka dorëzuar dokumentacion justifikues:

- Vërtetim page nr. ** prot, datë 13.04.2018, lëshuar nga DPPSH, ku vërtetohet se Astrit Latifi, për periudhën 16.06.1993 - 08.04.2004, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në

shumën 2.355.358 lekë, nga taksa e solidaritetit në shumën 442.800 lekë dhe shpërblimet në shumën 92.754 lekë.

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ** prot, datë 12.04.2018, ku evidentohet se Astrit Latifi për periudhën prill 2004 - prill 2005, ka përfituar të ardhura neto nga paga pranë Ministrisë së Brendshme, në shumën 582.522 lekë.
- Vërtetim datë 16.04.2018, lëshuar nga Raiffeisen Bank, ku evidentohet se në llogarinë e pagës në emër të Astrit Latifi, për periudhën 2005 - 2017, ka pasur kreditime në shumën 13.137.339 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank për llogari në emër të Astrit Latifit, ku evidentohet se për periudhën janar 2018 - prill 2021, ka përfituar të ardhura nga paga, dieta dhe ndihma, në shumën 4.050.126 lekë.

8.6-9.6 B/shorti i subjektit për periudhën 1993 - 2021, ka përfituar të ardhura nga pagat, shpërblimet, etj., në shumën totale rreth 20.661.000 lekë. Në përgjigjet e datës 01.02.2024, me kërkesë të trupës vlerësuese, subjekti ka dorëzuar lëvizjet bankare (nxjerrje llogarie) të b/shortit Z. Astrit Latifi për periudhën 2011 e në vazhdim. Shuma që do të merret në konsideratë në analizën financiare të subjektit është rreth 10.061.000 lekë, të cilat i përkasin të ardhurave në pagë, shpërblime, veshmbathje dhe ndihmë ekonomike të periudhës 2011 e në vazhdim, për të cilën b/shorti është person i lidhur i subjektit të vlerësimit.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ASHK Elbasan.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së krijuar pas vitit 2011, moment në të cilin Z. Astrit Latifi është personi i lidhur i subjektit të vlerësimit.**

10. Pasuri e paluajtshme, apartament, me sip. 86,07 m2. Nuk është aplikuar për regjistrim. Zotërimi 100%. Vlera 94.670 euro. Apartamenti i blerë në datë 03.02.2022, me kontratë sipërmarrje me sipërfaqe ndërtimi 86,07m2, nga e cila sipërfaqe ndërtimi 74,88 m2 dhe sipërfaqe përbashkët 11,19 m2. Kontratë sipërmarrje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.02.2022. Apartamenti i blerë me kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti me shoqërinë "Dinamo Invest".

Burimi i krijimit: 23.000 euro kalim nga gjendja e llogarisë sime në lekë xxxxxxxx, ose 2.792.200 lekë, 17.000 euro, burimi nga mbyllja e depozitës bankare të datës 01.02.2022, në shumën 500.000 lekë, nga të ardhurat gjendje në llogarinë e b/shortit tim Astrit Latifi, në datën 07.10.2021, në shumën 1.055.935 lekë në nr. llogarie xxxxxxxx Raiffeisen Bank, dhe pagat e datës 23.11.2021, në shumën 376.638 lekë e vërtetuar më printimet nga banka, në total

1.432.573 lekë, 131.227 lekë gjendje para të kursyera, të cilat janë përdorur për të blerë eurot. Kursi i këmbimit në datën 4 shkurt 2022 ka qenë 121,4 lekë 1 euro.

Kjo llogari është mbyll pasi është bërë 0 lekë në datën 04.02.2022, me likuidimin e kështit të parë për blerje apartamenti sipas kontratës nr. ** dhe nr. ** kol, për "Dinamo Invest" sh.pk.

Kësti i dytë në shumën 54.670 euro, nga shitja e apartamentit të mëparshëm me adresë Rr. "A. V.", Njësia administrative 9, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë. Apartamenti i mëparshëm shitur në vlerën 125.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.06.2022.

Subjekti ka deklaruar si adresë banimi: Rr. "****", pallati i ndërtuar nga shoqëria "Dinamo Invest", Apartamenti **, Njësia Administrative nr. 8, Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti me nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.02.2022, për apartament me sip. 86,07m². Porositës: Shpresa Latifi. Sipërmarrës: shoqëria "Dinamo Invest". Cmimi: 94.670 euro do të paguhet: kësti i parë 40.000 euro do të likuidohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës; kësti i dytë 56.670 euro do të likuidohet me bankë në çastin e dorëzimit të çelësave të apartamentit.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, ku evidentohet se në datë 04.02.2022, Shpresa Latifi, ka transferuar në llogarinë e shoqërisë "Dinamo Invest" sh.p.k, një shumë prej 40.000 euro.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, ku evidentohet se në dt. 05.07.2022, PF E. S., ka transferuar në llogarinë e Shpresa Latifit një shumë prej 124.950 euro, me përshkrimin "kalim sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.06.2022, nga kjo shumë në të njëjtën ditë, Shpresa Latifi ka transferuar në llogarinë e PF J. Zh., një shumë prej 56.671 euro, me përshkrimin "kësti i dytë sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol".
- Proces-verbal datë 30.09.2022, për dorëzim apartamenti, firmosur nga marrësi në dorëzim, Shpresa Latifi dhe dorëzuesi, shoqëria "Dinamo Invest" sh.p.k, ku pranohen se punimet janë kryer në përputhje me kontratën.
- Kontratë depozite datë 20.10.2017, lidhur mes Shpresa Latifi dhe BKT, për çelje depozite në shumën 500.000 lekë, me afat 1 vit. Shuma e interesit të përfituar, në shumën 3.729 lekë.
- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 15.04.2008, për pasuri e llojit apartament me nr. pasurie **, me sip. totale 102,06m² (93,26 + 9,36m² shkallë), Rr. "R. P.", Tiranë. Blerës: Shpresa Gashi. Shitës: Shoqëria "Usluga" sh.p.k. Çmimi: 32.175 euro, shumë e likuiduar.
- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme me rezervë me kalim pronësie nr. ** rep., nr. ** kol., datë 17.6.2022, për apartament me sip. 93,26 m², me nr. pasurie **, në Rr. "R. P.", Tiranë. Shitës: Shpresa Latifi. Blerës: B. K. Çmimi: 125.000 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 10.1 ASHK Tiranë, me shkresat nr. ** prot, datë 26.06.2023, datë 03.07.2023, datë 21.06.2023 dhe datë 07.07.2023, nuk konfirmojnë këtë apartament në emër të subjektit.
- 10.2 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Shpresa Latifi, me të ardhurat në llogarinë e pagës, në datë 04.01.2011, ka çelur një depozitë në shumën 500.000 lekë, të cilën e ka mbyllur në datë 08.04.2011, duke tërhequr shumën 504.600 lekë.
- 10.3 BKT me shkresën nr. ** prot, datë 09.05.2023, konfirmon se Shpresa Latifi, në datë 15.11.2011, ka depozituar cash një shumë prej 300.000 lekë, me të cilën në datë 16.11.2011 ka çelur një depozitë. Në këtë llogari ka depozituar cash në datë 07.09.2015, edhe një shumë prej 200.000 lekë dhe në datë 08.09.2015, pas mbylljes së depozitës së parë, ka çelur një depozitë tjetër në shumën 539.902 lekë. Kjo depozitë është mbyllur përfundimisht në datë 01.02.2022, kur është tërhequr cash një shumë prej 506.625 lekë.
- 10.4 Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie ku evidentohet se Shpresa Latifi, në datë 04.02.2022, nga llogaria e saj e pagës në monedhën Lekë, ka transferuar në llogarinë e saj në monedhën Euro, një shumë prej 2.792.200 lekë/ 23.000 euro dhe po në të njëjtën datë, ka depozituar cash një shumë prej 17.000 euro, me përshkrimin "të ardhura nga paga kursime ndër vite". Shumën e krijuar prej 40.000 euro e ka transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e shoqërisë "Dinamo Invest" sh.p.k., me përshkrimin "blerje apartamenti sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol.".
- 10.5 Gjithashtu, Tirana Bank ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie ku evidentohet se në llogarinë e Shpresa Latifi, në datë 05.07.2022, është transferuar nga PF(notere) E.S. një shumë prej 124.950 euro, me përshkrimin "kalim sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.06.2022. Nga shuma 124.950 euro Shpresa Latifi, në të njëjtën datë ka transferuar në llogarinë e PF J. Zh., një shumë prej 56.671 euro, me përshkrimin "kësti i dytë sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol.", shumë e cila i është rikthyer mbrapsht në datë 27.09.2022, me përshkrimin "gabim" dhe Shpresa Latifi këtë shumë e ka transferuar në llogarinë e shoqërisë "Dinamo Invest" sh.p.k., me përshkrimin "kësti i dytë sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol. Nga kjo llogari, Shpresa Latifi, në periudhën 05.07.2022 - 14.10.2022, ka tërhequr cash nëpërmjet disa veprimeve, një shume totale prej 33.200 euro. Në këtë llogari në datë 24.10.2022, është transferuar edhe një shumë prej 2.000 euro, me përshkrimin "kthim vlere sipas kontratës së porosisë". Gjendja e mbetur në këtë llogari, në datë 03.03.2023, është 32.071 euro.

- 10.6 FSHU, me shkresën nr. ** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se Shpresa Latifi, e identifikuar me ID xxxxxxxxxx, ka lidhur kontratë energjie elektrike për banesë me adresë Rr. "F. Xh.", "5 Maji", Tiranë, klienti me nr. ALxxxxx. Data e lidhjes së kontratës 15.09.2022.
- 10.7 UK Tiranë sha, me shkresën nr. ** prot, datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Shpresa Latifi, rezulton kontrata nr. xxxxxx për objektin me adresë rruga "5 Maji", Tiranë, me status Aktiv. Bashkëlidhur: Kontratë sipërmarrje per prenotim apartamenti datë 03.02.2022, për apartament me sip. 86.07m2. Porositës: Shpresa Latifi. Sipërmarrës: shoqëria "Dinamo Invest". Cmimi: 94.670 euro.
- 10.8 Në datë 12.07.2023, subjekti ka sqaruar se shuma e tërhequr nga llogaria e bashkëshortit në Raiffeisen Bank, prej 1.055.935 lekë, janë pagat e kaluara për vitin 2021, si dhe ato që kishin gjendje dhe nuk ishin tërhequr gjatë kohës që ndodheshin në Turqi. Subjekti sqaroi se pavarësisht se ka bërë likuidim total të apartamentit, zotëron vetëm kontratën (e sipërmarrjes) dhe proces-verbalin për dorëzim apartamenti.
- 10.9 Në lidhje me shumën 1.055.935 lekë, të cilën subjekti e ka tërhequr pranë ATM-ve përkatëse kryesisht në shumat 50.000 lekëshe nga data 15.10.2021 deri 04.12.2021, i është kërkuar sqarim pasi ajo shumë sipas Vendimit për lëshimin e Trashëgimisë Ligjore nr. ** rep., nr. ** kol., datë 09.03.2022 dhe bazuar në nenin 318 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, konsiderohet pjesë e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit, ku subjekti trashëgon 1/3 pjesë të saj.
- 10.10 Në shpjegimet e dhëna datë 16.01.2024, subjekti sqaron se: “Ajo shumë i përket pagave të vitit 2021, kohë në të cilën ne ishim në spital në Ankara dhe në certifikatë ishim vetëm unë dhe Astriti. Gjithashtu ka argumentuar: “Se kjo gjendje parash nuk ishte depozitë në bankë por të ardhura në llogari rrjedhëse dhe kartën e disponoja unë që kur u sëmur bashkëshorti im, megjithatë bashkëlidhur gjeni deklaratën noteriale me nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.03.2022 ku dhe dy pjesëtarët e tjerë trashëgimtarë ishin në dijeni”.
- 10.11 Trupa vlerësuese pasi administroi shpjegimet dhe dokumentacionin shoqërues të subjektit konstatoi se pavarësisht se nga se përbëhet kjo shumë si burim të ardhurash dhe pavarësisht se është depozitë apo është llogari rrjedhëse, veprimet bankare të kryera në llogari të të ndjerit pas vdekjes, nëpërmjet kartës së tij bankare apo pranë sporteleve të bankës, duhet të kryhen nga personi i autorizuar dhe në dijeni të trashëgimtarëve të tjerë. Ky kusht është plotësuar pikërisht me deklaratën noteriale të datës 18.03.2022 të cituar më lart.
- 10.12 Lidhur me shumën 33.200 euro tërhequr për periudhën korrik - tetor 2022, në Tirana Bank, subjekti sqaroi se me këtë shumë ka bërë pagesat shtesë për apartamentin ndaj firmës

ndërtuese, për parketin, pllakat pajisjet hidrosanitare dhe ka bërë kompletimin e banesës. Disponon vetëm disa fatura për shumën 339.445 lekë. Mobiljet i ka blerë në vende të ndryshme dhe jo të gjithë e kanë pajisur me faturë. Gjithashtu me shumat e tërhequra nga Tirana Bank ka kryer edhe shpenzime të nevojshme me ndarjen nga jeta të b/shortit, si dhe ka paguar faturat për ndërhyrjet mjekësore që bashkëshorti ka kryer në Tiranë.

Bashkëlidhur:

- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 18.06.2022, lëshuar nga NEPTUN, për blerësin Shpresa Latifi, për shumën 10.000 lekë
- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 10.07.2022, lëshuar nga NEPTUN, për blerësin Shpresa Latifi, për shumën 329.455 lekë.
- Faturë datë 15.04.2020, nga International Turkish Hospital (MedInstambul) për Astrit Latifin për ndërhyrje, në shumën 4.000 euro.
- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 15.07.2020, lëshuar nga MedInstambul për blerësin Astrit Latifi, për ndërhyrje, në shumën 4.000 euro.
- Faturë dt. 29.06.2020, nga International Turkish Hospital (MedInstambul) për Astrit Latifi për ndërhyrje, në shumën 2.000 euro.
- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 15.07.2020, lëshuar nga MedInstambul për blerësin Astrit Latifi, për ndërhyrje, në shumën 2.000 euro.
- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 15.07.2020, lëshuar nga MedInstambul sh.p.k., për blerësin Astrit Latifi, për ndërhyrje, në shumën 605 euro.
- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 06.10.2020, lëshuar nga Spitali Hygea për blerësin Astrit Latifi, në shumën 323.400 lekë.

10.13 Gjithashtu në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti ka specifikuar se pajisjet shtëpiake kanë kushtuar 339.445 lekë, mobilimi afërsisht 12.250 euro, dhe hidrosanitare dhe parketi (sipas dokumenteve 215.263 lekë dhe 1.115 euro). Për pagesën e tatimit për të ardhurat nga shitja e apartamentit në rrugën "R. P."/ose "A. V.", për shumën 125.000 euro, shpjegoi se vlera e apartamentit është rivlerësuar dhe cmimi përfundimtar ka qenë 15.000.000 lekë (prandaj nuk ka pasur detyrim për të paguar tatim). Bashkëlidhur paraqiti:

- Faturë datë 09.04.2022, nga Brunos sh.p.k., për blerje parketi, në shumën 183.803 lekë. Faturë tatimore shitje datë 29.04.2022, nga Billa sh.p.k, për blerje pajisjesh hidrosanitare, në shumën 31.460 lekë. Mandat arkëtimi datë 29.04.2022, nga Shpresa Latifi për Dinamo Invest, në shumën 730 euro.
- Preventiv pajisjesh hidro-sanitare, datë 20.05.2022, nga Dinamo Invest për Shpresa Latifi, në shumën 385 euro.
- Kërkesë nr. xxxx, datë 14.02.2022, për rivlerësim pasurie, bërë nga Shpresa Latifi pranë ASHK-së.

- Mandat arkëtimi datë 26.02.2022, për aplikim të bërë nga Shpresa Latifi për rivlerësim pasurie.
- Marrëveshje ndërmjetësimi datë 24.02.2023, lidhur mes Shpresa Latifi dhe agjencisë "Century 21 Abitat".

10.14 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Subjekti në vitin 2022 ka porositur blerjen e një apartamenti në rrugën "5 Maji" në Tiranë, duke paguar të plotë cmimin e tij në shumën 94.670 euro, por ende nuk ka lidhur kontratën përfundimtare të shitblerjes. Si burim financiar për blerjen e këtij apartamenti subjekti ka deklaruar 40.000 euro kursime të krijuara nga të ardhurat ndër vite, si dhe 54.670 euro të përfituara nga shitja e apartamentit në rrugën "R.P.", në Tiranë.

10.15 Me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në rrugën "Reshit Petrela, në shumën 125.000 euro, subjekti ka paguar këstin e dytë prej 54.671 euro, ka kryer shpenzime për mobilim e blerje pajisjesh për apartamentin e ri në rrugën "5 Maji" në rreth 12.500 euro dhe 3.750 euro ka paguar komision 3% të vlerës nga shitja e apartamentit për llogari të Century 21 sipas marrëveshjes së datës 24.02.2022, si dhe ka kryer pagesa faturash spitalore për mjekimin e b/shortit në rreth 6.605 euro dhe 323.400 lekë. Gjendja e mbetur në këtë llogari në Tirana Bank është në shumën 32.071 euro (deklaruar më poshtë).

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur. ASHK nuk e konfirmon të regjistruar këtë apartament, pasi nga sa ka deklaruar subjekti nuk e ka lidhur ende kontratën e shitblerjes.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

11. Llogari rrjedhëse në Tirana Bank, nr. 0130-xxxxxxx. Vlera 32.071 euro. Zotërimi 100%. Data e balancës 03.03.2023. Gjendja nga shitja e pasurisë apartamenti i mëparshëm shitur në vlerën 125.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.06.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Shpresa Latifi, ku evidentohet se gjendja në llogari në datë 01.03.2023, është në vlerën 32.071 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

11.1 Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku janë evidentuar lëvizjet e llogarisë, të cilat janë trajtuar më lart në pikën 10.5. Gjendja e mbetur në këtë llogari në datë 03.03.2023, është 32.071 euro.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Tirana Bank.**
- ✓ **Burimi financiar i kësaj llogarie është i trajtuar më lart.**

12. Bono Thesari në Tirana Bank, nr. 0130-xxxxxxx. Vlera 700.000 lekë. Zotërimi 100%. Data e investimit 12.09.2019. Data e maturimit 12.09.2026. Norma e interesit 4,19%. Vlera nominale 700.000 lekë. Burimi i krijimit: shuma 700.000 lekë, kursime nga paga ndër vite.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim blerje obligacione kuponi fiks në Tirana Bank nga Shpresa Latifi, datë 10.09.2019, me afat 7-vjeçar, me datë maturimi 12.09.2026, në vlerën nominale 700.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

12.1 Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se subjekti ka blerë obligacione me vlerë 700.000 lekë për një afat 7-vjeçar. Referuar nxjerrjeve të llogarive, shuma 700.000 lekë ka pasur si burim financiar kreditimet e pagave dhe pagesën në datë 13.08.2019, të një kuponi Obligacioni në shumën 500.000 lekë, blerë në vitin 2014.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Tirana Bank.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

13. Llogari rrjedhëse në Tirana Bank, nr. 0130-xxxxxxxx. Vlera 1.031.782 lekë. Zotërimi 100%. Data e balancës 03.03.2023. Burimi i krijimit: shuma 1.031.782 lekë, kursime nga paga dhe ndihmë ekonomike në shumën 543.000 lekë kjo sipas urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. **, datë 2.11.2022 për pagesën e shpenzimeve për trajtimin mjekësor të

specializuar për ish-punonjesin Astrit V. Latifi. Kjo shumë ka rimbursuar shpenzimet për blerjet e kimiove në Ankara Turqi në mars dhe nëntor të vitit 2020.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Shpresa Latifi, ku evidentohet se gjendja në llogari në datë 02.03.2023, është në vlerën 1.031.782 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

13.1 Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Shpresa Latifi, në datë 03.03.2023, ka llogari rrjedhëse (page) me gjendje 1.031.782 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Tirana Bank.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura të krijuara nga kontrata e shitjes nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.01.2001 për apartamentin në Rr. "H. H.", "Pallati i Policisë", (ndarje e pasurisë me ish-b/shortin). Shuma 1.800.000 lekë.
- Të ardhura të krijuara nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 07.03.2005 në Rr. "I. T.", në shumën 1.900.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e autoveturës Seat Ibiza, nuk kam dokumentacionin e shitjes, në shumën 480.000 lekë, shitja është bërë në fund të vitit 2005 ose fillim 2006.
- Të ardhura nga funksioni ekonomiste/nënoficere dhe oficere në Drejtorinë e Qarkut Tiranë, sot DVP Tiranë për periudhën 01.10.1991 deri më 15.10.2008 (vërtetuar me vërtetim nga DVP Tirana dhe nga banka). Shuma 6.401.529 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shefe Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit nga data 16.10.2008 deri në datën 31.03.2018, e vërtetuar me printimet nga banka. Shuma 9.378.684 lekë.

- Të ardhura nga blerja e obligacioneve 500.000 lekë me afat 5-vjeçar nr. i ankandit 20, dt. 11.08.2014, deri me 11.08.2018, bruto 165.500 lekë - 15% tatimit = 140.670 lekë.
- Hua të marra nga vëllai A. Gashi pa interes emigrant në Athinë, Greqi që nga viti 1997 e në vijim. Marrë në dhjetor të vitit 2007. Shuma 500.000 lekë.
- Të ardhura nga blerja e obligacioneve (700.000 lekë) me afat 7-vjeçar, nr. ankandit 23, datë 12.09.2019, deri 12.09.2026, të ardhura neto deri në datën 31.12.2022. Shuma 74.590 lekë.
- Të ardhura nga USA N. K., me nr. reference xxxxxxx, datë 22.10.2020, përpunimi xxxxx/kasa nr. xxxxxx. Personi dhurues është motra me banim në SHBA (NJ), i kanë shkruar mbiemrin gabim. Shuma 3.000 Lira turke.
- Të ardhura nga USA, V. Xh., me nr. reference xxxxxxx, datë 30.7.2021 (Është mbesa ime, vajza e motrës N. Xh., SHBA). Shuma 2.000 USD.
- Të ardhura nga USA, N. Xh., me nr. reference xxxxxxx, datë 21.01.2021 (është motra ime, N. Xh., SHBA). Shuma 2.500 USD.
- Të ardhura nga USA, V. Xh., me nr. reference xxxxxxx, datë 21.01.2021 (Është mbesa ime, vajza e motrës N. Xh., SHBA). Shuma 2.000 USD.
- Nga të ardhurat gjendje në llogarinë e b/shortit tim Astrit Latifi, në datën 07.10.2021, në shumën 1.055.935 lekë në nr. llogarie 0100xxxxxxx Raiffeisen Bank dhe pagat e datës 23.11.2021 në shumën 376.638 lekë e vërtetuar me printimet nga banka. Shuma në total 1.432.573 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit me adresë Rr. "A. V.", Nj. Admin 9, Tiranë. Apartamenti i mëparshëm shitur në vlerën 125.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.06.2022, 50 euro komisioni i bankës. Shuma 124.950 euro.
- Të ardhura nga funksioni Shefe e Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit nga data 31.03.2018, deri në datën 16.01.2023, e vërtetuar me printimet nga banka (janë zbritur ndihmat që kanë rimbursuar shpenzimet dhe shpenzimet e udhëtimit), shuma 543.000 e datës 30.12.2022 është përfshirë si gjendje 7.286.006 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Drejtor i Drejtorisë së Financave nga data 16.01.2023, deri në datën 28.02.2023, e vërtetuar me printimet nga banka. Shuma 239.605 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.01.2001, për apartament në Rr. "H. H.", "Pallati i Policisë", Tiranë. Shitës: Shpresa Duraku. Blerës: Azem Duraku. Shitësi shet ½

e pasurisë (pjesën e vet takuese, blerësit Azem Duraku. Cmimi: 1.800.000 lekë, shumë e likuiduar.

- Kontratë shitje nr. ** rep, nr. ** kol, datë 07.03.2005, për apartment me sip. (71,5m²), me nr. pasurie **, ne Rr. "I. T.", Tiranë. Shitës: Shpresa Gashi. Blerës: B. T. Cmimi: 1.900.000 lekë, i lëvruar jashtë zyrës noteriale.
- Tabelë përmbledhëse, e krijuar nga subjekti, ku sipas subjektit nga data 01.10.1991 - 28.02.2023, janë përfituar të ardhura nga pagat në shumën totale 23.305.824 lekë.
- Vërtetim blerje obligacione kuponi fiks në Tirana Bank nga Shpresa Latifi, datë 11.08.2014, me afat 5-vjeçar, me datë maturimi 13.08.2019, në vlerën nominale 500.000 lekë.
- Vërtetim blerje obligacione kuponi fiks në Tirana Bank nga Shpresa Latifi, datë 10.09.2019, me afat 7-vjeçar, me datë maturimi 12.09.2026, në vlerën nominale 700.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për periudhën 01.01.2018 - 02.03.2023, për llogari në emër të Shpresa Latifit, ku evidentohen kreditimet e pagave, shpërblimeve, veshjeve, dietave, ndihmës financiare, rimbursimeve, pagesat e kuponit të obligacioneve.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për periudhën 07.12.2020 - 25.11.2021, për llogari në emër të Astrit Latifi, ku evidentohen kreditimet e pagave dhe ndihmave.
- Vërtetim të ardhurat nr. ** prot, datë 28.02.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, për Shpresa Latifin, për periudhën tetor 1991 - prill 2005, ku ka përfituar të ardhura nga pagat dhe shpërblimet në shumën 4.020.775 lekë (mungojnë listë-pagesat e plota për periudhën 2001 - 2002).
- Transfertë me Money Gram, datë 22.10.2020, nga shtetasi N. K., për Shpresa Latifi, në shumën 15.437 Lira turke.
- Transfertë me Money Gram, datë 21.01.2021, nga shtetasja V. Xh., për Astrit Latifi, në shumën 2.000 USD.
- Transfertë me Money Gram, datë 21.01.2021, nga shtetasja N. Xh., për Shpresa Latifi, në shumën 2.500 USD.
- Transfertë me Money Gram, datë 30.07.2021, nga shtetasja V. Xh., për Shpresa Latifi, në shumën 2.000 USD.
- Urdhër nr. **, datë 02.11.2022, i Ministrit të Brendshëm, i cili urdhëron pagesën e shpenzimeve për trajtim mjekësor të specializuar në Turqi për ish-punonjësin Astrit

Latifi, në bazë të faturave origjinale të lëshuara nga institucioni shëndetësor, si dhe pagesën e shpenzimeve për udhëtim.

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për periudhën 17.05.2005 - 23.12.2010, për llogari në emër të Shpresa Gashi, ku evidentohen kreditimet e pagave.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për periudhën 06.01.2011 - 04.04.2018, për llogari në emër të Shpresa Latifi, ku evidentohen kreditimet e pagave, shpërblimeve, veshjeve, dietave, ndihmës financiare, rimbursimeve, pagesat e kuponit të obligacioneve.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie ku evidentohet, se për periudhën 17.05.2005 - 23.12.2010, Shpresa Gashi ka përfituar të ardhura nga pagat, shpërblimet, orë shtesë, dieta, etj., në shumën 4.817.316 lekë.
2. Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se në llogarinë e Shpresa Latifi, në datë 05.07.2022, është transferuar nga PF E. S., një shumë prej 124.950 euro, me përshkrimin "kalim sipas kontratës nr. ** rep, nr. ** kol, datë 17.06.2022. Gjithashtu evidentohet se për periudhën 01.01.2011 - 03.03.2023, ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, etj., në shumën 13.809.057 lekë.
3. Të ardhura nga punësimi sipas funksioneve përkatëse të mbajtura pranë Policisë së Shtetit për periudhën viti 1991 deri viti 2023, rezultojnë në total 21.881.515 lekë të pasqyruara përkatësisht sipas viteve në tabelën e analizës financiare.
4. Në datë 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku deklaroi se motra N. Xh. ka shkuar në SHBA para 21 vitesh dhe është shtetase amerikane bashkë me fëmijët e saj. Motra e ka ndihmuar financiarisht bashkë me vajzën e saj, në kohën që ishin në Ankara për trajtimin mjekësor të b/shortit gjatë vitit 2020 dhe janar - shtator 2021. Vajza e motrës, V.Xh. është e punësuar në Aeroport, ndërsa motra në një shkollë. Paratë i kanë kursyer nga pagat e tyre. Shuma që i ka dërguar motra është 4.500 USD, një shumë prej 2.000 USD është dërguar dhe konvertuar në lira turke në shumën 15,437 lira (që gabimisht e ka deklaruar në shumën 3000 lira) dhe një shumë tjetër prej 2.500 USD, ndërsa mbesa V. Xh. i ka dërguar 2.000 USD.
5. Gjithashtu me postë elektronike datë 26.06.2023 nga N. Gashi, e cila deklaroi se prej 22 vitesh jeton familjarisht në New York, SHBA, ku edhe punon prej 13 vitesh në "New York School Support Services", ndërsa vajza në aeroportin "Laguardia". Bashkë me vajzën e saj, kanë ndihmuar motrën, Shpresa Latifin me një shumë prej 6.500 USD, nga të cilat 4.500 USD nga vetë N. Gashi dhe 2.000 USD nga vajza e saj. Këto shuma i kanë dërguar gjatë

kohës kur motra e saj po kuronte b/shortin në Turqi. Një shumë prej 2.000 USD është dërguar dhe konvertuar në lira turke në shumën 15,437 lira. Burimi financiar i tyre deklaroi se kanë qenë të ardhurat e tyre.

6. Të ardhurat e subjektit nga interesat bankare dhe Bonot e Thesarit, për periudhën 2004 - 2022, janë në shumën rreth 220.000 lekë.
7. Të ardhurat e subjektit nga ndihma financiare për b/shortin, për periudhën 2021 - 2023, janë në shumën rreth 870.500 lekë. Subjekti ka marrë ndihmë nga familjarët e saj edhe një shumë prej 6.500 USD dhe 15.437 Lira turke (që gabimisht e ka deklaruar në shumën 3000 lira).
8. Gjithashtu ndër vite subjekti ka përfituar të ardhura nga shitja e apartamenteve:

1.661.193 lekë (pasi është zbritur tatimi dhe vlera takuese e cmimit të blerjes) nga shitja e apartamentit në Rr. "H. H.", Tiranë në vitin 2001.

180.000 lekë (neto pas tatimit) nga shitja e apartamentit në Rr. "I. T.", Tiranë, në vitin 2005 (blerë 1.700.000 lekë dhe shitur 1.900.000 lekë).

92.825 euro, nga shitja e apartamentit në Rr. "A. V.", Tiranë, në vitin 2022 (blerë 32.175 euro dhe shitur 125.000 euro).
9. Të ardhurat e b/shortit të subjektit, janë trajtuar më lart.

DETYRIME FINANCIARE

1. Hua të marra nga vëllai A. Gashi pa interes emigrant në Athinë, Greqi që nga viti 1997 e në vijim. Marrë në dhjetor të vitit 2007 me të cilat kam prenotuar apartamentin në vitin 2008, detyrimi është paguar nga kursimet nga të ardhurat familjare (vëllai ka ndërruar jetë në prill të vitit 2021).

Trajtuar më lart.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

1. Shpenzime për vitin 2022, për ujë në shumën 11.656 lekë për 7 muaj të vitit 2022, gusht-dhjetor kam blerë banesë të re dhe nuk ka dalë akoma kontrata e ujit, elektricitet në shumën 34.391 lekë për 11 muaj. Telefon celular në shumën 6.000 lekë dhe internet në shumën 22.800 lekë. Shuma 74.847 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2. FSHU, me shkresën nr. ** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se Shpresa Latifi, e identifikuar me ID xxxxxxxxxx ka lidhur kontratë energjie elektrike për banesë me adresë Rr. "F. Xh.", "5 Maji", Tiranë, klienti me nr. ALxxxxxx. Data e lidhjes së kontratës 15.09.2022. Për periudhën nëntor - dhjetor 2020, klienti ka paguar në total 5.412 lekë.
3. UK Tiranë sha, me shkresën nr. ** prot, datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Shpresa Latifi, rezulton kontrata nr. xxxxx-1 për objektin me adresë Rr. "5 Maji", Tiranë, me status Aktiv. Bashkëlidhur: Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti datë 03.02.2022, për apartment me sip. 86,07m². Porositës: Shpresa Latifi. Sipërmarrës: shoqëria "Dinamo Invest". Cmimi: 94.670 euro. UKT ka bashkëlidhur pagesat për periudhën janar - prill 2023.
4. Vodafone sh.a., me shkresën nr. ** prot, datë 13.07.2023 konfirmon se për vitin 2022, Shpresa Latifi për numrin e celularit 06941xxxxx, ka shpenzuar 6.690 lekë dhe 24.786 lekë (internet).
5. Në datë 12.07.2023, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim, ku ka shpjeguar për shpenzimet e energjisë sipas kopjes së librezës për 11 muaj në shumën 34.391 lekë (banesa e vjetër 25.965 lekë dhe banesa e re 8.426 lekë), për shpenzimet e ujit në shumën 11.656 lekë (vetëm banesa e vjetër), internetin në shumën 22.800 lekë për të dyja banesat, ndërsa për celularin sqaroi se ka tarifë fikse nga puna në shumën 500 lekë në muaj* 12 =6.000 lekë, si dhe ka dorëzuar:
 - Librezë nr. xxxxxx lëshuar nga KESH për Shpresa Gashi.
 - Librezë nr. AL00xxxxx lëshuar nga OSHEE për Shpresa Latifi.
 - Librezë nr. xxxxxx lëshuar nga UKT për "Usluga
 - Librezë nr. xxxxx-1 lëshuar nga UKT për Shpresa Gashi.
 - Kontratë datë 11.01.2021, lidhur mes Shpresa Latifi dhe Vodafone për Internet dhe TV në shumën 1.800 lekë/muaj.
6. Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara subjekti ka deklaruar:

- 6.1 Shpenzime udhëtimi në Ankara, Turqi 01 - 17 janar 2020, 16 ditë (bileta udhëtimi në shumën 33.936 lekë), shpenzime akomodimi dhe ushqimi në shumën 734 Lira turke) qëndruam në MSB Refatkaci Misafirhabesi, Keçiorem Ankara, hotel për ushtarakët në Ankara (shpenzimet spitalore për kurimin e b/shortit janë marrë përsipër me marrëveshje nga Ministria e Shëndetësisë, Turke). Shuma 33.936 lekë.
- 6.2 Shpenzime udhëtimi në Ankara Turqi 15.03 deri më 19.03.2020 (bileta udhëtimi në shumën 31.980 lekë), shpenzime akomodimi dhe ushqimi në shumën 215 Lira turke. Blerë kimio për tu bërë në Tiranë në shumën 23.652 Lira turke, kjo shumë është rimbursuar në datën 20.12.2022, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 215, dt. 02.11.2022, për pagesën e shpenzimeve për trajtimin mjekësor të specializuar për ish-punonjësin Astrit Veli Latifi. Shuma 31.980 lekë; 215 Lira turke; dhe 23.652 Lira turke.
- 6.3 Shpenzime udhëtimi në Ankara Turqi nga data 18.01 - 30.09.2021, kemi vetëm shpenzimet e udhëtimit (pasi kemi qëndruar në spital tërë periudhën) Shpenzime transporti nga Ankaraja në Rinas në shumën 1.500 euro. Rimbursuar nga Ministria e Transportit për shumën 101.500 lekë, kaluar në llogari në datën 03.06.2022. Shuma 42.350 lekë dhe 1.500 euro. Shpenzime udhëtimi në Ankara Turqi 10.10, deri 04.11.2020 (bileta udhëtimi në shumën 26.010 lekë), shpenzime akomodimi dhe ushqimi në shumën 1.265 Lira turke).
- 6.4 Shpenzime udhëtimi në Athinë, Greqi 05.05.2022 - 11.05.2022, vetëm shpenzime për bileta udhëtimi, pasi akomodimi dhe ushqimi janë përballuar nga kunata, nusja e vëllait dhe nipat. Shuma 70 euro.
- 6.5 Shpenzime udhëtimi në Volos, Greqi 05.05 - 11.05.2022, vetëm shpenzime për bileta udhëtimi, pasi akomodimi dhe ushqimi janë përballuar nga kunata, nusja e vëllait dhe nipat. Shuma 70 euro.
- 6.6 Shpenzime udhëtimi në Igumenicë, Greqi vajtje - ardhje brenda ditës 26.11.2022, vetëm shpenzime për siguracion mjete, mjetin e kishte shoqja ime në pronësi me targa AB 485CL. Shuma 20 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kthim përgjigje nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, për Shpresa Latifin, ku e informon lidhur me hyrje - daljet jashtë vendit për periudhën 2020 - 2022, dhe konkretisht 6 dalje dhe 7 hyrje.

6.7 Me inventarin nr. extra prot., datë 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim ku ka shpjeguar se bashkëshorti gjatë viteve 2019 - 2020 është trajtuar falas për kurim në spitalin shtetëror, në Ankara, Turqi, sipas marrëveshjes të

lidhura midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Turke. Me "Notën verbale" të datës 18.03.2020 Ambasada e Republikës së Turqisë, për shkak të Pandemisë COVID-19, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Shqipëri dhe u ka njoftuar pezullimin për një periudhë të pacaktuar të shërbimeve falas në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, për pacientët shqiptarë për kurim në Shtetin e Turqisë. Në kushtet e emergjencës shëndetësore, shërbimet e mëtejshme spitalore për kurimin e sëmundjes së b/shortit, i kanë mbuluar me burime private në Tiranë. Lidhur me shpenzimet për udhëtimet e deklaruara në Greqi, subjekti shpjegoi se të vetmet shpenzime janë biletat e udhëtimit për në Athinë dhe në Volos, ku ka shkuar me autobus dhe ka qëndruar 5 netë tek shtëpia e vëllait dhe po kështu dhe tek kunati në Volos Greqi, ka shkuar me autobus së bashku me kunatën e saj dhe mbesat e bashkëshortit kanë qëndruar tek shtëpia e tij. Nuk ka ruajtur faturat e biletave të udhëtimit, shpenzime të tjera nuk ka bërë. Bashkëlidhur paraqiti:

- Shkresë nr. ** prot, dt. 11.11.2019, dërguar nga Ministri i Brendshëm, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes ku kërkohet trajtimi mjekësor në Turqi të punonjësit Astrit Latifi.
- Urdhër nr. **, dt. 13.11.2019, lëshuar nga Ministri i Mbrojtjes, për kurim jashtë shtetit në Fakultetin e Mjekësisë "Gulhane", Ankara, Turqi, të Major Astrit Latifi. Mbulimi financiar i shpenzimeve apo rimbursimeve të paparashikuara në protokoll-marrëveshje, do të jenë përgjegjësi e Gardës së Republikës.
- Faks-mesazh nr. ** prot., datë 13.11.2019, nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dërguar Ambasadës së Republikës së Turqisë në Shqipëri, ku i përcjell dokumentacionin mjekësor të Major Astrit Latifit.
- Urdhër nr. **, datë 16.01.2019 (2020), lëshuar nga Ministri i Mbrojtjes, për kurim jashtë shtetit në Fakultetin e Mjekësisë "Gulhane", Ankara, Turqi, të Major Astrit Latifi. Mbulimi financiar i shpenzimeve apo rimbursimeve të paparashikuara në protokoll-marrëveshje, do të jenë përgjegjësi e Gardës së Republikës.
- Vërtetim shërbimi datë 02.12.2019 (turqisht), nga Ministria e Mbrojtjes Turke, ku referon pacientin Astrit Latifi për trajtim në spitalin "Gulhane".
- Dokument datë 03.03.2020 (turqisht), nga Ministria e Mbrojtjes Turke, për trajtimin e pacientit Astrit Latifi.
- Kthim përgjigje nr. ** prot, datë 17.11.2020, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, drejtuar Astrit Latifit, ku e informon "Notën verbale" nga Ambasada e Turqisë dhe pezullimin e shërbimeve për kurim në Turqi.
- Faturë datë 17.03.2020 (në turqisht), për Astrit Latifin, në shumën 23.652 Lira Turke.

- Faturë datë 15.04.2020, nga International Turkish Hospital (MedInstambul) për Astrit Latifin për ndërhyrje, në shumën 4.000 euro.
- Faturë tatimore shitje datë 15.07.2020, lëshuar nga MedInstambul sh.p.k., për blerësin Astrit Latifi, për ndërhyrje, në shumën 4.000 euro.
- Faturë datë 29.06.2020, nga International Turkish Hospital (MedInstambul) për Astrit Latifin për ndërhyrje, në shumën 2.000 euro.
- Faturë tatimore shitje datë 15.07.2020, lëshuar nga MedInstambul sh.p.k., për blerësin Astrit Latifi, për ndërhyrje, në shumën 2.000 euro.
- Faturë tatimore shitje datë 15.07.2020, lëshuar nga MedInstambul sh.p.k., për blerësin Astrit Latifi, për ndërhyrje, në shumën 605 euro.
- Faturë tatimore shitje datë 06.10.2020, lëshuar nga Spitali Hygea për blerësin Astrit Latifi, në shumën 323.400 lekë.
- Faturë datë 04.11.2020 (në turqisht), për Astrit Latifin, në shumën 2.514 euro.
- Postë elektronike datë 26.06.2023 nga H. Gashi, dërguar Shpresa Gashi (Latifi), ku deklaroi se është djali i A. Gashi dhe Shpresa Latifi është halla e tij. Në datën 5 maj, Shpresa Latifi ka udhëtuar drejt Greqisë dhe ka qëndruar në shtëpinë e tyre në Athinë.
- Postë elektronike datë 27.06.2023 nga A. Latifi, dërguar Shpresa Gashi (Latifi), ku deklaroi se kunata e tij Shpresa Latifi bashkë me kunatën tjetër, dhe fëmijët e saj, në periudhën 15.07.2022 - 24.07.2022 kanë qenë tek banesa e tij në Volos, Greqi.

Subjekti, për periudhën në fjalë ka përballuar financiarisht vetë shpenzime spitalore për b/shortin në Shqipëri në shumën 323.400 lekë dhe 6.605 euro.

Përvec sa më sipër:

- Banka e Shqipërisë, ISP Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Fibank, Banka Amerikane & Investimeve, Credins Bank, Union Bank, OTE Bank. Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, LandsLease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, AK Invest, EasyPay, Fondi Besa, NOA sha, IuteCredit, Kred.al, 13 Shoqëri Rajonale të UK, ONE Albania sha, Albanian Satellite Communication sh.p.k.. Abissnet, DIGICOM, konfirmon se Shpresa Latifi, nuk është klient i tyre, c`ka përputhet me deklarinimin e subjektit.
- ASHK në zyrat/drejtoritë vendore: Korçë, Skrapar, Kukës, Durrës, Tropojë, Bulqizë, Pukë, Peqin, Mirditë, Tepelenë, Kuçovë, Kavajë, Gramsh, Malësi e Madhe, Lushnjë, Lezhë, Mallakastër, Gjirokastrë, Berat, Krujë, Devoll, Librazhd, Fier, Mat, Sarandë, Dibër, Has,

Pogradec, Vlorë, Shkodër, Kurbin, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit.

- Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot., konfirmon se në datë 04.08.2016, shtetasja M. H. ka depozituar në llogarinë e Shpresa Latifit, një shumë prej 17.000 lekë me përshkrimin "likujdim qira për muajin gusht 2016" dhe në datë 16.08.2016, Shpresa Latifi ka transferuar në llogarinë e shtetasit Luan Rahim, një shumë prej 17.000 lekë me përshkrimin "pagesë qira gusht 2016".
- Me inventarin nr. extra prot., datë 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, sqarime me shkrim ku deklaroi se për transaksionin e konfirmuar nga Tirana Bank, gabimisht një punonjëse e bankës i ka kaluar në llogari shumën prej 17,000 lekë. Në datën 04.08.2016 është njoftuar nga banka për t'u paraqitur për të bërë rregullimet dhe kalimin e shumës nga llogaria e saj në llogarinë që duhej, veprim që e ka kryer në datën 16.08.2016. Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar nga Tirana Bank.
- QKB, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë të pajisur me NIPT, si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.
- DPT, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.
- Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ** prot, datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të Shpresa Latifit.
- Nga veprimet bankare rezulton se subjekti ka transferuar në datën 02.12.2019 shumën 500.000 lekë me përshkrimin transfertë, kalim fondi për F. Ibrahim Gashi dhe gjithashtu në datën 25.09.2020 ka kryer përsëri një transfertë në shumën 300.000 lekë për F. Ibrahim Gashi me përshkrimin kalim për pagesë kësti shtëpie. Nga ana e trupës i është kërkuar subjektit të japë sqarime për transfertat e mësipërme.
- Në përgjigjet e datës 16.01.2024 subjekti i vlerësimit ka sqaruar se: "Janë pagesa të bëra nga ana ime për vëllain tim F. Ibrahim Gashi, punonjës policie, i cili është larguar në muajin Korrik 2023 nga puna për qëllim emigrimi, lekët ja kam dhënë për pagesën e kësteve të shtëpisë".
- Nga ana e trupës kjo shumë është vendosur si shpenzim në tabelën e analizës financiare.
- Në datë 13.01.2023 subjekti ka tërhequr 5.000 euro nga llogaria bankare. I është kërkuar nga ana e trupës të japi shpjegime në lidhje me destinacionin e përdorimit të kësaj shume.

- Sipas përgjigjeve të administruara në datë 16.01.2024, subjekti është shprehur se: “Kam ribërë varrin e bashkëshortit pasi u dëmtua, kam paguar biletën e udhëtimit në USA si dhe për shpenzime të tjera. Udhëtimi ka qenë në periudhën maj-qershor 2023”.
- Nga regjistri noterial është evidentuar se sipas deklaratës noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., bashkëshorti i subjektit, Astrit Latifi në datë 01.11.2017 i ka dhënë shtetasit I. Gj. shumën monetare prej 300.000 lekë. I është kërkuar subjektit të japi sqarime në lidhje me qëllimin e këtij veprimi dhe lidhjen e këtij shtetasi me bashkëshortin.
- Në përgjigjet e datës 01.02.2024 subjekti sqaron se: “Pagesën e ka bërë për qeranë e banesës së fëmijëve, ju ka paguar një vit për ti ndihmuar ekonomikisht, në shtëpi nuk i gjeta asnjë dokument por komunikova me fëmijët e Astritit dhe më sqaruan”
- Nga ana e trupës kjo shumë është vendosur si shpenzim në tabelën e analizës financiare.
- Në deklaratën noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 08.02.2014, bashkëshorti A. Latifi deklaroi se është banues në qytetin e Elbasanit në lagjen “Dyli Haxhire Myzyri” dhe pavarësisht se ka qenë i divorcuar me ish –bashkëshorten e tij, për shtëpinë private një katëshe 83 m2 në adresën më sipër, është shprehur se vazhdon të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet për energji elektrike dhe ujë. Subjektit i është kërkuar të na vërë në dispozicion dokumentacionin përkatës që të vërtetojë pagesat e lartpërmendura nga ana e bashkëshortit të saj që prej vitit 2011 e në vazhdim.
- Subjekti sqaron se: “Bashkëshorti im ka jetuar në Tiranë që nga viti 2011 e deri në fund të jetës, unë nuk kam informacion se si është bërë pagesa për këtë kohë, pasi aty ka jetuar vjehrra dhe fëmijët disa kohë, pastaj fëmijët kanë banuar në Tiranë dhe shpenzimet i ka paguar ish-bashkëshortja pasi ajo jeton në atë shtëpi. Numri i kontratës është në emër të Astrit Latifi me nr. xxxx Elbasan dhe kontrata e ujit me nr. xxxx Elbasan. Megjithatë arrita mora nga sistemi printimet për vitet 2011-2021 për energjinë, të cilat po jua bashkëlidh.”
- Trupa administroi dokumentacionin dhe të dhënat përkatëse dhe i ka pasqyruar në rubrikën shpenzime në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të.
- Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për vitet 2009-2019, ashtu si dhe për tre vitet e fundit, vlerat e shpenzuara janë të papërfillshme pasi sipas shpjegimeve të subjektit të dorëzuara datë 01.02.2024, ka qëndruar tek të afërmit e saj dhe shpenzimet e kryera janë vetëm bileta ose shpenzime karburanti e siguracion mjeti. (subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur tabelë shpjeguese)

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;*
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;*
- ç) nuk është kryer deklarim i rremë;*
- d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Tabela nr.1
Analiza Financiare e subjektit Shpresa Ibrahim Latifi dhe personave të saj të lidhur

| Burimi/Viti | 1991 | 1992 | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2019 | 2020 | 2021 | jan-shkurt 2022 | mar-dhjet 2022 | 2023 | TOTALI | | | | |
|---|-------|--------|--------|--------|----------|---------|---------|---------|---------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|-----------------|----------------|-------------|------------|-------------|-------------|-----------|-----------|
| Te ardhura neto nga paga apo shperfitime nga marredheniet e punesimit Sh.Latifi | 5,646 | 23,675 | 37,379 | 85,275 | 119,816 | 170,426 | 166,755 | 275,489 | 370,672 | 416,110 | 394,070 | 554,649 | 544,457 | 637,012 | 611,898 | 585,605 | 798,496 | 873,162 | 893,092 | 1,077,615 | 786,307 | 809,346 | 940,034 | 983,437 | 1,148,948 | 966,864 | 1,156,018 | 1,107,118 | - | 1,089,146 | 1,264,758 | 1,409,799 | 208,216 | - | 1,041,078 | 329,147 | 21,881,515 | | | |
| Te ardhura neto nga paga apo shperfitime nga marredheniet e punesimit A.Latifi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 407,318 | 947,091 | 950,128 | 1,007,528 | 1,079,840 | 1,077,864 | 1,116,040 | 1,119,664 | 1,139,908 | | 885,458 | 330,328 | | | | | 10,061,167 | | | | |
| Te ardhura neto nga interesat bankare | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 4,600 | | | | | | 39,902 | 3,729 | | | | | 8,125 | | | | 56,336 | | | | |
| Te ardhura nga ndihme financiare | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 870,500 | | | | | 870,500 | | | | |
| Te ardhura te krijuara nga shitje e pasurive te luajshme dhe te paluajshme | | | | | | | | | | 1,661,193 | | | | | 180,000 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 10,889,321 | | 12,780,514 | | | | |
| Te ardhura te krijuara nga investimi ne tituj | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 28,136 | 28,136 | 28,136 | 28,136 | 28,136 | 24,930 | 24,930 | 24,930 | | | | | 215,470 | | | |
| Te ardhura te pa përmendura ne kart | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Te hyra nga dhurimet | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 207,628 | 665,010 | | | | | 870,638 | | | | |
| Totali i Ardhurave dhe te hyrat | 5,646 | 23,675 | 37,379 | 85,275 | 119,816 | 170,426 | 166,755 | 275,489 | 370,672 | 2,077,303 | 394,070 | 554,649 | 544,457 | 637,012 | 791,898 | 585,605 | 798,496 | 873,162 | 893,092 | 1,077,615 | 1,198,225 | 1,756,437 | 1,890,162 | 1,990,965 | 2,256,924 | 2,072,864 | 2,340,096 | 2,258,647 | 1,139,908 | 1,117,282 | 2,382,774 | 3,298,567 | 241,271 | - | 11,930,399 | 329,147 | 46,686,160 | | | |
| Detyrime: Te hyra nga huatë/kredi | | | | | | | | | | | | | | | | | 500,000 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 500,000 | | | |
| Shpenzime jetike sipas INSTAT | 3,952 | 16,573 | 26,165 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 108,000 | 93,612 | 93,612 | 93,612 | 93,612 | 110,712 | 110,712 | 235,728 | 136,620 | 213,252 | 213,252 | 426,504 | 279,096 | 279,096 | 630,274 | 692,157 | 661,747 | 723,911 | 772,620 | 759,312 | 768,564 | 561,780 | | | 559,920 | 93,320 | 9,117,716 | | | | |
| Shpenzime per mobilim | | | | | | | | | | 120,000 | | | | | | 175,000 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1,865,600 | | 2,160,600 | | |
| Shpenzime per Mjekim | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1,149,421 | | 1,149,421 | |
| Shpenzime per Arsimim | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | - | | |
| Shpenzime Udhëtimi jashte vendit | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 17,811 | 17,811 | | |
| Shpenzime qeraje per fëmijet e A.Latifi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 300,000 | | | | | | | | | | 300,000 | | | |
| Shpenzime E.Elektriper fëmijet e A.Latifi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 14,476 | 29,143 | 24,612 | 30,363 | 34,433 | 19,518 | 5,903 | 7,608 | | 28,238 | 39,113 | 24,926 | | | | | 258,333 | | | |
| Shpenzime dhe te dala te tjera-këmbim borxhi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 500,000 | | | | | | | | | | | | | | | | | 500,000 | | | |
| Totali i shpenzimeve dhe te dalave | 3,952 | 16,573 | 26,165 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 60,000 | 228,000 | 93,612 | 93,612 | 93,612 | 93,612 | 110,712 | 285,712 | 235,728 | 136,620 | 213,252 | 213,252 | 440,980 | 308,239 | 303,708 | 660,637 | 726,590 | 681,265 | 1,029,814 | 780,228 | 500,000 | 787,550 | 2,257,098 | 586,706 | - | - | 2,443,331 | 93,320 | 14,303,880 | | | |
| Investime pasuri | | | | | 132,758 | | | | | - 132,758 | 1,700,000 | | | | | - 1,700,000 | | | | | | | | 100,000 | 500,000 | 552,898 | | | | | | | | | 4,856,000 | - | 6,501,903 | 12,710,801 | | |
| Investime pasuri | | | | | | | | | | | | | | | | 3,342,060 | 634,869 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 3,976,929 | - | | |
| Likuiditete ALL/Tirana Bank(nderyshimi) | | | | | | | | | | | | | | | 44,560 | 71,746 | 185,052 | - 226,841 | 38,172 | 438,296 | - 549,742 | 43,767 | 320,696 | 159,945 | 174,142 | - 126,500 | 129,704 | - 109,974 | | - 122,390 | 476,108 | 2,121,271 | | | | | - 1,956,082 | 239,742 | 1,031,782 | |
| Likuiditete EURO Tirana Bank (nderyshimi) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 4,856,000 | - 4,856,000 | - 576,241 | 3,659,065 |
| Likuiditete ALL BKT Bank(nderyshimi) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 300,000 | | | | 228,392 | 11,510 | - 39,902 | | | | | | | 8,125 | | | | - 508,125 | - | |
| L.k./ ALL/ Raiffeisen Bank A.Latifi(nderyshimi) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 500,258 | 9,934 | 178,936 | 564,766 | - 89,438 | 63,535 | 366,759 | 345,775 | | 262,222 | - 428,916 | - 643,302 | | | | | - 250 | 747 | | |
| Gjeoije Cash (nderyshimi: shim i pakesim) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | - | | |
| Totali Pasuri | | | | | 132,758 | | | | | - 132,758 | 1,700,000 | | | | | - 1,655,440 | 3,413,806 | 185,052 | 408,028 | 38,172 | 438,296 | 250,516 | 53,701 | 599,632 | 224,711 | 865,994 | - 51,455 | 456,561 | 235,801 | - 500,000 | 839,832 | 47,192 | 1,486,094 | 9,712,000 | - 4,856,000 | 4,295,823 | - 336,499 | 17,402,395 | | |
| Mundesia per Kursete : Te Ardhura+Detyrime-Shpenzime-Pasuri: | 1,694 | 8,796 | 20,010 | 45,285 | - 27,657 | 82,769 | 189,524 | 405,013 | 848,443 | 997,746 | 1,298,204 | 1,759,241 | 2,210,086 | 2,753,486 | 5,090,112 | 1,976,199 | 2,853,915 | 3,182,429 | 3,824,097 | 3,750,164 | 4,256,893 | 5,651,390 | 6,638,212 | 8,193,251 | 8,857,590 | 10,300,644 | 11,154,365 | 12,396,983 | 13,536,891 | 13,026,791 | 13,105,275 | 14,331,042 | 4,860,313 | 9,716,313 | 14,907,559 | 15,479,884 | | | | |

B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Objekti i kontrollit të figurës, sipas nenit 35 të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në katër elementë:
 - (i) *të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;*
 - (ii) *raporti i hollësishëm dhe i arsytuar i strukturës përgjegjëse pranë AMP-së sipas përcaktimeve të Nenit 42, pika 1 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;*
 - (iii) *të dhënat e mbledhura nga Trupa e Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 3, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;*
 - (iv) *verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërma (ë), e Ligjit 12/2018, i ndryshuar.*
3. Subjekti Shpresa Latifi ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në zbatim të Nenit 36, pika 1 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
4. Trupa Vlerësimit ka proceduar në tre momente të rëndësishme të verifikimit të figurës sipas Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar:
 1. *Fillimisht është administruar dhe verifikuar Formulari i Kontrollit të Figurës i plotësuar nga subjekti si detyrim i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.*
 2. *Është administruar dhe verifikuar Raporti mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e vlerësimit nr. ** prot. datë 18.07.2023, i hartuar dhe vënë në dispozicion të trupës në përmbushje të nenit 42, pika 1 e Ligjit 12/2018, i ndryshuar.*
 3. *Dhe më tej janë administruar përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese.*
5. Në Raportin mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e vlerësimit nr. ** prot., datë 18.07.2023, përgatitur nga AMP, jemi informuar se subjekti i vlerësimit Shpresa Latifi është i përshatshëm për vazhdimin e detyrës.

6. Në Deklaratën për Kontrollin e Figurës¹, Subjekti i vlerësimit, Shpresa Latifi, nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kritereve dhe kushteve të ligjit nr.138/2015 dhe në zbatim të detyrimit të ligjit të posaçëm nr. 12/2018, i ndryshuar.

Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, janë kryer veprimet në disa institucione duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës pranë këtyre institucioneve:

- ✚ **AKSIK**
- ✚ **SHISH**
- ✚ **AMP**
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**
- ✚ **Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore**
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**
- ✚ **Avokati i Popullit**
- ✚ **AISM**
- ✚ **Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)**
- ✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**
- ✚ **DPPPP**

1

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka patur shtetësi tjetër.
- Nuk është dënua ndonjëherë më vendim gjyqësor të formës të prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë penale.
- Nuk ka patur urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.
- Nuk është në dajni të përfshirjes së ndonjë nga anëtarët e familjes në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm, me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë ushtrimit të detyrës.
- Nuk është në dajni që anëtarët e familjes kanë patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dajni që ndonjë nga anëtarët e familjes të ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Gjatë 10 viteve të fundit, nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqraportuar, falsifikuar, një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të vecantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të pa autorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar ndonjëherë azil politik.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi nga alkali dhe lojrat e fatit.
- Nuk ka vuajtur nga crregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991 sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

7. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të Nenit 36 -37 të ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar, bazuar në kontrollin e deklarimeve dhe marrjes së informacionit apo materialeve të tjera nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, duke i vlerësuar ato bazuar në dispozitat e neneve 38 - 41 të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar.

8. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, ka rezultuar se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit nuk është e pajisur me Certifikatë Sigurimi Personeli (CSP) të vlefshme. Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Nga verifikimi i dosjes së personelit, Trupa konstaton se subjekti ka qënë e pajisur me CSP të vlefshme deri në 05.05.2021. Me e-mailin e datës 22.01.2024 i është kërkuar Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë AMP-së, të na informojë në lidhje me ecurinë e këtij procesi, nëse ka qënë ose jo i nevojshëm rinovimi i CSP-së për subjektin e vlerësimit, Znj. Shpresa Latifi dhe në të dyja rastet të na vërë në dispozicion bazën ligjore justifikuese.

Po në këtë datë, me e-mail është sqaruar nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit se: “Funksioni i Drejtor i Drejtorisë së Financës, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nuk ka qasje në asnjë nga dokumentat e miratuara me Vendimin nr. ** datë 17.11.2021, të Komisionit të Klasifikimit të Informacionit “Sekret shtetëror, “Për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Ministrinë e Brendshme dhe strukturat në varësi të saj”, pra nuk është në kushtet e “nevoje për njohje” me informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Gjithashtu funksioni “Drejtor i Drejtorisë së Financës, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit” nuk është parashikuar si funksion që për shkak detyrës duhet të njihen me informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” në draftin e Policisë së Shtetit me “Funksionet organike në Policinë e Shtetit që për shkak detyrës duhet të njihen me informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, dërguar për miratim pranë Komisionit të Klasifikimit të Informacionit “Sekret shtetëror. Sa më sipër Znj.**Shpresa Ibrahim Latifi, nuk është në proces pajisje me CSP pasi rinovimi i CSP-së nuk ka qënë i nevojshëm.**”

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën e saj konfirmon se shtetasja Shpresa Latifi:
Me martesë më datë 07.09.1989, ka ndryshuar mbiemrin nga “Gashi” në “Duraku” dhe ndryshon vendbanimin nga ish Njësia Administrative në Bashkinë Kukës.

Me martesë më datë 09.07.2011, ka ndryshuar mbiemrin nga “Gashi” në “Latifi” dhe ka ndryshuar vendbanimin nga Njësia Administrative nr.5, Bashkia Tiranë në Bashkinë Elbasan.

- ✓ Nuk ka patur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit, konfirmuar me shkresë.
- ✓ Nuk ka denoncime nga publiku në faqen zyrtare të AMP dhe nuk disponohen ankesa për subjektin e vlerësimit.
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresë konfimon se shtetasja Shpresa Ibrahim Latifi rezulton e padënuar.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se subjekti i vlerësimit nuk është i përfshirë në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundraligjshme.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen e saj në aktivitete të kundërligjshme.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk figuron e regjistruar për veprimtari kriminale.
- ✓ Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK informon se për subjektin e vlerësimit nuk ka nxjerrë urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa të sigurimit personal (masa shtrënguese/ masa ndaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo person nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimit të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale.
- ✓ Institucioni ligjzbatues për subjektin e vlerësimit informon se nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm dhe nuk ka procedime penale të referuara.
- ✓ AIDSSH-ja për subjektin e vlerësimit bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991.

9. Testimi për përdorim lëndësh narkotike

9.1 Në zbatim të Nenit 38, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale, subjekti i vlerësimit ka kryer testin për përdorim lëndësh narkotike.

9.2 Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. 92, të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. ** prot., datë 11.01.2024, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit ***nuk u zbulua*** prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP (opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepine).”

✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***

- a) punonjësi nuk ka kryer deklaram të rremë;***
- b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;***
- c) nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

C- VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit; respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në zbatim të ligjit të vlerësimit nr.12/2018, i ndryshuar si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimit në nenin 43 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
2. Analiza ligjore e vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në:
 - a) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - b) të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 6, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - c) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë DPPSH-së sipas përcaktimeve të Nenit 46, pika 2 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
3. **Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:**
 - 3.1 Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon *formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.

- 3.2 Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e Nenit 44 pika 2 dhe 3 e tij ².
- 3.3 Subjekti i vlerësimit kalimtar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit ka ushtruar detyrën e Drejtore e Drejtorisë së Financës në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- 3.4 Trupa përdor si burime për vlerësimin e aftësive profesionale, elementet vlerësuese të përcaktuara në nenin 45, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- 3.5 Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe merr në shqyrtim edhe nëse ka denoncime nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë joetike.

4. Niveli i arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

- 4.1 Subjekti i vlerësimit sipas të dhënave të administruara ka përfunduar arsimin e lartë dhe është diplomuar:
- Datë 09.07.1992, Titulli “Ekonomist Agrar”, Diploma nr.100, Universiteti Bujqësor i Tiranës(Kamëz).
- 4.2 Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit në vite, Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, bazuar dhe në kriteret dhe kërkesat e vecanta të pozicioneve të punës për funksionet përkatëse që ka mbajtur subjekti për periudhën e përcaktuar në pikat 2 e 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, rezulton se: Subjekti i vlerësimit ka qenë në përmbushje dhe përputhje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar, si dhe me gradat policore që ka mbajtur si punonjës i Policisë së Shtetit.

5. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

- 5.1 Neni 45, pika 2, shkronja dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.
- 5.2 Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore e Policisë së Shtetit na ka vënë në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i

².Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet. 3. Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës.

përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve, etj... të cilat janë marrë në analizë për vlerësimin profesional të subjektit. Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- **Shefe Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit në Drejtorinë e Financave, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit** për periudhën 20.02.2016 deri në 04.06.2018 - sipas *Urdhërit nr. 377/2, datë 16.02.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.*
- **Shefe Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit në Drejtorinë e Financave, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit** për periudhën 05.06.2018 deri në 13.01.2023 - sipas *Urdhërit nr. 2010/1, datë 04.06.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*
- **Drejtores e Drejtorisë së Financës, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit** për periudhën 16.01.2023 deri në momentin e dorëzimit të Formularit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale dhe aktualisht - sipas *Urdhërit nr. 55/1, datë 13.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

5.3 Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit ka përfituar gradat policore si më poshtë:

Kryekomisar: Urdhër nr.37, datë 17.06.2008

Drejtues: Urdhër nr.842, datë 13.03.2013

5.4 Bazuar në nenin 179, pika 10 e Rregullores së Policisë së Shtetit përcaktohet se *transferimi i punonjësit të Policisë bëhet bazuar në kriteret e përcaktuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me gradën, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës, kohën e qëndrimit në funksion, si dhe me përshkrimin e pozicionit të punës për atë funksion.*

5.5 Sipas VKM nr.531, datë 29.07.2022 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”, në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për funksionin “Drejtues në Departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, duhet që punonjësi të ketë gradën “Drejtues i Parë”.

5.6 Subjekti i vlerësimit Shpresa Latifi, në momentin e emërimit dhe aktualisht mban gradën “Drejtues”.

5.7 Sipas nenit 180, pika 1 e Rregullores së Policisë së Shtetit, *punonjësi i Policisë mund të transferohet dhe të emërohet në detyrë në çdo strukturë të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka.*

5.8 Në rastin e transferimit dhe emërimit në detyrë të subjektit, si Drejtore e Drejtorisë së Financës, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nuk është mbajtur parasysh përputhja e funksionit me gradën sipas legjislacionit në fuqi të sipërcituar.

5.9 Grada “Drejtues” që mban subjekti i vlerësimit Shpresa Latifi, megjithëse është jashtë periudhës së vlerësimit të aftësive profesionale, por nisur nga fakti se është grada aktuale, është marrë në shqyrtim nga ana e Trupës Vlerësuese. Nga administrimi i dokumentave në dosjen e personelit, subjekti është shpallur fitues në konkurimin për gradën “Drejtues” datë 27.11.2012 dhe ka përfunduar me sukses kursin e trajnimit për ngritje në gradën “Drejtues” sipas certifikatës së lëshuar datë 01.03.2013 nga Qendra e Formimit Policor.

5.10 Me Urdhërin nr.842, datë 13.03.2013 “Për ngritjen në gradë të një punonjësi policie” të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, K/Komisar Shpresa Ibrahim Latifit i jepet grada policore “Drejtues”.

5.11 Në përfundim rezulton se grada është përfituar në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

6. Vlerësimet e punës:

6.1 Neni 45, pika 2, shkronja ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe vlerësimet e punës.

6.2 Nga aktet e depozituara pranë Trupës Vlerësuese rezulton se gjatë 5(pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga punëdhënësit për rezultate individuale të punës si më poshtë:

6.3 Për vitin 2018, 2019, 2020 me vlerësimin “shumë mirë” (28 pikë në total) për të gjithë treguesit si: integriteti, profesionalizmi, komunikimi efektiv, qëndrimi konstruktiv, paanshmëria, puna në grup dhe organizimi i punës.

6.4 Për vitin 2021 nuk ka të administruar në dosje vlerësim pune, konfirmuar kjo dhe me shkresën nr.2645/92 prot., datë 21.07.2023 të ardhur nga DPPSH.

6.5 Për vitin 2022 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” (96 pikë në total), duke arritur për komponentin e “realizimit të objektivave të punës” të vlerësohet me 56 pikë nga 60 pikë në total dhe për komponentin e “sjelljes profesionale” është vlerësuar me 40 pikë nga 40 pikë në total.

6.6 Subjektit të vlerësimit me rastin e 110-Vjetorit të Policisë së Shtetit i është dhënë “Certifikatë për Shërbime të Dalluara”, datë 13.01.2023.

6.7 Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresë ka konfirmuar se nuk ka pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin.

6.8 Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës të tij sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

7. Përbushja e detyrave të kryera

7.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përbushja e detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës që rregullon veprimtarinë e punonjësit.

7.2 Neni 45, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për cdo funksion.

7.3 Nga verifikimi rezulton se subjekti ka kryer dhe ka përbushur detyrat në përputhje me përshkrimet e punës për cdo funksion.

8. Respektimi i rregullave të etikës:

6.8 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe respektimi i rregullave të etikës.

6.9 Nga verifikimi dosjes së personelit, rezultoi se ndaj subjektit të vlerësimit nuk ka masa disiplinore në fuqi apo të parashkruara për shkelje të rregullave të etikës, sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

7 Kualifikimet dhe trajnimet:

7.1 Nga verifikimi dosjes së personelit si dhe pikës 3 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me çertifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit të listuara si më poshtë:

- Licensë profesioni nga Instituti i Ekspertëve Fiskalë, Ekspert Fiskal -2014
- Kurs kompjuteri mbi kontabilitetin- programi “Alpha” - 2007
- Kurs trajnimi "Njohuri për programin EXCEL 2007” -2010
- Hartimi i Buxhetit - 2008
- Trajnim projekt binjakëzimi "Mbështetja kundër pastrimit të parave dhe strukturave investiguese të krimit financiar në Shqipëri
- Kurs kompjuteri për programin “Financë 5” - 2007
- Kurs në programet bazë te kompjuterit - 2001
- Mbeshtetje buxhetore Sektori i BE-së - 2015
- Përfshirja e parimeve të barazisë gjinore në sistemin e menaxhimit të financave publike - 2016
- Puna me informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"- 2017
- Prezantimi i Udhëzimit të ri Standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm- 2018
- Bashkëpunimi për zhvillimin e sigurisë
- Kurs modulet financiare dhe teknikat e trajnimit - 2008
- Zgjidhja dhe transformimi i konfliktit për drejtuese në sektorin e sigurisë - 2013
- Kurs mbi kuadri logjik i planifikimit - 2016
- Mbi menaxhimin e ciklit të projekteve – 2017

7.2 Trajnimet dhe pajisja me certifikata trajnimi janë kryer gjatë ushtrimit të detyrës së saj si punonjëse e strukturës dhe se ato janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të saj në detyra të ndryshme ku ka punuar.

8 Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, botime

Nuk ka të tilla pjesëmarrje nga ana e subjektit. (Pjesëmarrjet në konferenca shkencore, nuk administrohen në dosjen e personelit pasi nuk janë pjesë e saj).

- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*
 - a) *është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
 - b) *ka vlerësime pozitive pune;*
 - c) *ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.*

V. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit Znj. **Shpresa Latifi**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Znj. Shpresa Ibrahim Latifi, me funksion Drejtore e Drejtorisë së Financës në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **24.04.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Henri Naqellari
Kryesues

Loreta Hanxhari
Relatore

Bora Vrenjo
Anëtare

